



10 vjetori
i themelimit
të OMK-së

10 Vite Punë dhe Përkushtim

Shkrime nga:

- Pleurat Sejdiu
- Ferid Agani
- Salih Berisha
- Imet Rrahmani
- Ramin Parsa - Parsi
- Domen Podnar
- Zylfije Hundozi
- Fatmir Brahimaj
- Afërdita Ademi - Osmani





ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

[www.omk-rks-org/revista mjeku](http://www.omk-rks-org/revista%20mjeku)

revistamjeku@omk-rks.org

+383 49 872 300 ; +383 49 872 070, +383(0)38 544 872

QKUK, INSTITUTI A, KATI III, 10000 - PRISHTINË

LUXEMBOURG
AID & DEVELOPMENT



Kontribut të jashtëzakonshëm në themelimin dhe zhvillimin institucional të Odës së Mjekëve të Kosovës ka dhënë Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut përmes projektit për shëndetësi në Kosovë.

Revista Mjeku
Revistë e Odës së Mjekëve të Kosovës
Vëllimi 3, Numër 2, Qershor 2023
Publikohet 4 herë në vit.

Këshilli redaktues/ Editorial board:

Astrit Hamza
Dafina Bytyqi- Shabani
Edea Blyta
Elton Bahtiri
Faik Hoti
Fisnik Kurshumliu
Ibadete Bytyçi
Linda Çarkaxhiu- Huseyin
Lul Raka
Naser Gjonbalaj

web faqja:

www.omk-rks.org/revista-mjeku

Redaksia:

revistamjeku@omk-rks.org

+383 49 872 300

+383 49 872 070

+383 (0)38 544 872

QKUK, Instituti A, Kati III, 10000,

Prishtinë

Koordinatori ndërlidhës: Elira Selimi

Numri i radhës botohet në Dhjetor 2023
Dorëshkrimet pranohen në sekretarinë e
revistës deri me datë 01 Nëntor 2023.

Te gjitha dorëshkrimet vlerësohen
nga këshilli redaktues para botimit.

Përmbajtja e artikujve nuk reflekton
në mënyrë të domosdoshme qëndrimet e
këshillit redaktues.

Materialet e publikuara janë pronë e
Revistës Mjeku.



Astrit Hamza



Dafina Bytyqi Shabani



Edea Blyta



Elton Bahtiri



Faik Hoti



Fisnik Kurshumliu



Ibadete Bytyçi



Linda Çarkaxhiu
Huseyin



Lul Raka



Naser Gjonbalaj

Përmbajtja

Faqe

Aktualitete në Odën e Mjekëve të Kosovës

Oda e Mjekëve të Kosovës - Sfidat	7
-----------------------------------	---

Temat e numrit

Oda e Mjekëve të Kosovës - Suksesi i parë i reformës së sistemit shëndetësor	8
OMK të fuqizohet si organizata e vetme për organizim profesional të mjekëve	09-10
Puna për pacientët në Kosovë- Vetqeverisja solide mjekësore nxit cilësinë në kujdesin shëndetësor	11-12
Vetqeverisja kërkon një profesion mjekësor me vetëbesim	13-14
OMK është duke e përmbushur misionin dhe përgjegjësitë e saj	15-16
OMK ishte segmenti që i mungonte organizimit në shëndetësinë Kosovare	17
OMK dhe UMSH erdhën si risi në shëndetësinë e Kosovës e Shqipërisë	19-20
Shkrim nga Oda e Mjekëve të Kroacisë	21
Dhjetë vjet rrugëtim - Krijimi dhe zhvillimi i organizatave të suksesshme profesionale - Historia e mbështetjes së Odës së Mjekëve të Kosovës	22
OMK ndër vite	23-25
Revista Mjeku	26
Oda e Mjekëve të Kosovës - Dekoratat	27-29
Konferencat e organizuara nga OMK	30-31
Sondazhi: OMK me besueshmëri të lartë në mesin e mjekëve	32-34
Nxitja e bashkëpunimit të shëndetshëm dhe transparent ndërmjet kompanive farmaceutike dhe Odës së Mjekëve të Kosovës	35-36

Kalendari i aktiviteteve

37

Oda e Mjekëve të Kosovës - Sfidat



Pleurat Sejdiu

Kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës

Oda e Mjekëve të Kosovës, tash 10 vite e themeluar, kishte sfidat dhe problematikat e saj deri në arritjen e etapës vetëqeverisëse.

Rrugëtimi për themelimin e Odës së mjekëve dhe pavarësisë apo siç njihet në konceptin modern si vetëqeverisje e mjekëve për të zhvilluar veprimtarinë e tyre, nuk ishte aspak i lehtë, por ky qëllim u arrit pas shumë sfidave dhe vështirësive dhe me ndihmën e pakontestueshme dhe vullnetin politik të qeverive të Republikës së Kosovës

Si rrjedhojë e gjendjes jo të kënaqshme në shëndetësi dhe në drejtim të zbatimit të reformave të sanksionuara me ligj, në vitin 2018 filloi bartja e kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë dhe atë për mbikëqyrjen etike profesionale, licencimin dhe ri-licencimin dhe edukimin e vazhdueshëm profesional, të profesionistëve shëndetësorë tek Oda e Mjekëve të Kosovës.

Gjatë këtyre viteve me shumë sfida dhe vështirësi në zbatimin e ligjeve në fuqi, Oda e Mjekëve të Kosovës, përmes anëtarëve të saj, tentoi dhe u angazhua në sigurimin e standardeve të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovimin dhe mbrojtjen e veprimtarisë së profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike, private, si dhe publiko-private, sigurimin dhe lehtësimin e edukimit të vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore.

Kontribut të jashtëzakonshëm në themelimin dhe zhvillimin institucional të Odës së Mjekëve të Kosovës ka dhënë Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut përmes projektit për shëndetësi në Kosovë, odat simotra të Gjermanisë, Kroacisë dhe së fundmi CPME – Komiteti i Përhershëm të Mjekëve të Evropës.

Hapi i parë i funksionalizimit të Odës ishte gjithsesi regjistrimi i anëtarësisë, proces i cili filloi vetëm 4 vite pas lindjes së Odës, më shkurt 2018, dhe tani numri i anëtarëve të OMK-së ka arritur në gjithsej 5299 mjekë.

Oda, gjatë këtyre viteve, ka organizuar dhe financuar 59 aktivitete me mbi 23.000 pjesëmarrës.

Përveç këtyre detyrave, OMK, përmes fushatave publike, tryezave, debateve, intervistave dhe reagimeve publike, i ka dhënë rëndësi të veçantë luftës publike kundër stigmatizimit të punëtorëve shëndetësorë dhe në veçanti mjekëve. Ky stigmatizim, këto sulme verbale e fizike dhe baltosje, janë shndërruar fatkeqësisht tanimë në fenomen.

Po ashtu, OMK, përmes potencialit të vet, u ka ofruar ndihmë dhe bashkëpunim të gjitha organeve qeveritare në drejtim të formësimit dhe zbatimit të reformave në shëndetësi, por jo vetëm.

Fatkeqësisht, jo çdo herë ka hasur në bashkëpunim dhe partneritet!

Përkushtimi i mjekut tonë tanimë është dëshmuar, me vite, me dekada, përmes sakrificave nëpër demonstrata, dënimeve dhe përndjekjes politike, luftës, dhe së fundit pandemisë, e cila edhe na i mori 21 kolegë.

Andaj, Oda e Mjekëve të Kosovës është dhe do të jetë gjithmonë në shërbim të mjekëve dhe mburojë e atyre që janë shembull i përkushtimit dhe sakrificës, i mjekëve mantel dhe faqebardhë, si pjesë e pandashme e shoqërisë dhe nevojave dhe vuajtjeve të saj.

“Ubi cumque amatur ars medica, ibi amor humanitatis”
(Kudo që dashurohet arti i Mjekësisë, ka edhe dashuri për Njerëzimin) do të thoshte Hipokrati.

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS - SUKSESI I PARË I REFORMËS SË SISTEMIT SHËNDETËSOR



Ferid Agani

Ish-Ministër i Shëndetësisë

Synimi im politik që nga ditët e para të mandatit si Ministër i Shëndetësisë në vitin 2011 ishte që të themelohet njëra prej tri shtyllave kryesore të reformës së sistemit shëndetësor të vendit, shtylla e resurseve mirë të organizuara profesionale njerëzore që do të ishte në gjendje të bartë përgjegjësin e shtuar publike të profesionistëve shëndetësorë në procesin e reformës, si ndaj qytetarëve ashtu edhe ndaj institucioneve relevante vendore e ndërkombëtare. Këtë qëllim e realizuam me sukses nëpërmjet partneritetit bashkëpunues ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, shoqatave profesionale në lëmit e mjekësisë, stomatologjisë, farmacisë, infermierisë dhe fizioterapisë, organizatave sindikale në këto lëmi, Agjencionin për Zhvillim të Qeverisë së Luksemburgut dhe Federatën e Mjekëve të Republikës Federale të Gjermanisë. Në fund të procesit mjaftë kompleks, që nga njëra anë përfshinte komponentin legjislativ e nga ana tjetër atë organizative dhe menaxherial, me Ligjin për Odat e Profesionistëve shëndetësorë, të miratuar me 4 korrik 2013, u themelua për herë të parë në historinë e shëndetësisë kosovare Oda e Mjekëve të Kosovës, si e para prej pesë odave profesionale. Ky ishte sukcesi i parë i reformës së sapo filluar shëndetësore.

Konsideroj se Oda e Mjekëve të Kosovës i ka përmbushur objektivat e përcaktuara me strategjinë shëndetësore të Kosovës dhe legjislacionin në fuqi. Ajo, në mes të tjerave, nga njëra anë ka mundësuar integrimin organizativ e funksional të mjekëve të Kosovës e nga ana tjetër ka sigurua mekanizma për zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional. Duke siguruar procese cilësore, mirë të kontrolluara, të regjistrimit dhe licencimit të mjekëve nga njëra anë dhe specializimit e sub-specializimit të tyre nga ana tjetër, Oda e Mjekëve të Kosovës ka përmbushur rolin e saj publik duke avancuar cilësitë profesionale, etike e morale të anëtarëve të saj si dhe duke artikuluar interesat specifike të mjekëve në procesin e reformës shëndetësore dhe proceset relevante shoqërore.

Aktualisht, sfida kryesore me të cilën ballafaqohet Oda e Mjekëve është fuqizimi i rolit të saj në procesin e vazhdimin të reformës së ndër-

prerë shëndetësore në vitin 2015, proces ky i cili i vetmi do të krijon shpresën për avancimin e shpejtë të shëndetësisë kosovare, tejkalimin e vështirësive aktuale dhe përmirësimin substancial të perspektivës profesionale e materiale të mjekëve të Kosovës. Vlerësoj se Oda e Mjekëve duhet të jetë shumë më e zëshme dhe më e vendosur në kërkesat për zbatimin e legjislacionit në fuqi që rregullon dy shtyllat e tjera të reformës shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi (shërbimet e mjekësisë familjare dhe Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës) dhe Ligjin për Sigurime Shëndetësore që rregullon funksionimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Mendoj se ky është interesi jetik i mjekëve dhe detyra prioritare e organizatës së tyre përfaqësuese në këtë kohë të stagnimit serioz të shëndetësisë kosovare.

Oda e Mjekëve duhet të shndërrohet në promotor dhe gjenerator të reformës shëndetësore në vend, rezultat i parë i së cilës edhe ka qenë; është kjo përgjegjësi historike të cilën, jam i bindur, mjekët e Kosovës së bashku me profesionistët në odat e tjera shëndetësore do ta përmbushin me sukses. Oda e Mjekëve të Kosovës, do të mund të realizojë të gjitha potencialet e saja transformuese vetëm në rrethanat e një sistemi të reformuar shëndetësor, prandaj insistimi i saj në vazhdimin e menjëhershëm të reformës së ndërprerë në vitin 2015, nëpërmjet transformimit të SHSKUK në ndërmarrje publike të nivelit qendror dhe funksionalizimit të plotë të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, paraqet imperativ të kohës.

Më ka lënë mbresë të paharrueshme dita kur disa vite pasi që u largova nga posti i Ministrit të Shëndetësisë hyra në hapësirat e Odës si mjekëve për të përmbushë obligimet e mia ligjore të rilicencimit. Ishte kënaqësi e jashtëzakonshme të shih të jetësuar me sukses një vizion tëndin politik. Për këtë, falënderojë përzemërsisht të gjithë bashkëpunëtorët e mi, vendor e ndërkombëtar, udhëheqjet e Odës, e veçanërisht kolegët e mi, mjekët e të gjitha profileve profesionale, që këtë vizion timin politik e përmbushën me sukses të plotë.

Zoti i Madhërishtëm e priftë me të mbara Odën e Mjekëve të Kosovës.



Nënshkrimi i Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore

OMK TË FUQIZOHET SI ORGANIZATA E VETME PËR ORGANIZIM PROFESIONAL TË MJEKËVE



Salih Berisha

Një nga iniciatorët dhe kontribuesit për themelimin e OMK-së

*Shefi Qendrës Rhine-Neckar Shunt
Mjek i lartë,
Specialist në kirurgji dhe kirurgji vaskulare,
Klinika GRN Schwetzingen,
Gjermani*

Dr. Salih Berisha, mjek në Oberarzt, Facharzt für Chirurgie und Gefäßchirurgie në Gjermani është një nga iniciatorët e parë për themelimin e Odës së Mjekëve të Kosovës. Në dhjetë vjetorin e themelimit të OMK-së, ai tregon për mënyrën si lindi ideja për themelimin e kësaj ode, kontribuesit nga Gjermania dhe bashkëpunimin me autoritetet shëndetësore të Kosovës për krijimin e organizatës që do të përfaqësojë mjekët e Kosovës.

Dr. Berisha, me kë ishte diskutuar së pari kjo ide dhe cilat ishin pritjet e para? Kush ishin ekspertët e huaj që, krahas jush, ndihmuan në themelimin e Odës së Mjekëve të Kosovës?

Unë kam udhëhequr një projekt bashkëpunimi profesional shumë fisnik dhe produktiv në fushën e Kirurgjisë së përgjithshme ndërmjet Klinikës Universitare të Mannheim-it dhe asaj të Prishtinës, për tetë vjet. Dominonte kirurgjia, por ishin edhe shumë fusha të tjera mjekësore të inkuadruara në projekt me një vëllim financiar afër dy milion euro.

Në vitin 2010 (Artikulli Deutsche Ärzteblatt 08/2010) kam shkruar dhe publikuar bashkë me miqtë dhe përkrahësit e mi një artikull për këtë projekt që ka qenë ndër tjerash i sponsorizuar edhe nga Ministria e Jashtme e RFGJ-së. Pak ditë pasi është publikuar ky artikull, më kanë kontaktuar nga Berlina (Bundesärztekammer Berlin - Oda Federative e Mjekëve) Dr. Ramin Parsa-Parsi, udhëheqës i Departamentit për marrëdhënie me jashtë dhe Domen Podnar, referent i lartë në këtë departament. Kemi biseduar në një telekonferencë gjerë e gjatë për organizimin e mjekëve të Kosovës dhe shëndetësinë në Kosovë. Habi e tyre ishte pse në asnjë nga takimet e shumta ndërkombëtare që këta i organizojnë, nuk merr pjesë asnjë përfaqësues nga Kosova. Konkluzioni nga biseda e parë me ta ishte të kuptojmë se a ekziston një OMK në Kosovë dhe nëse jo, si mundemi të aktivizohemi që të bëhet diçka e tillë?

Duke e parë rëndësinë substanciale të projektit, kam biseduar dhe jam informuar drejtpërdrejt në IKSHPK nga prof. Naser Ramadani dhe prof. Isuf Dedushaj; në QKUK; në MSh; në Qeveri të Kosovës (nga dr. Shaip Muja, këshilltar i Kryeministrit për Shëndetësi në atë kohë), se në Kosovë nuk kishte Odë të mjekëve të Kosovës. Pastaj morëm iniciativën për një odë të tillë me dr. Shaipin, unë, Dr. Ramin Parsa-Parsi dhe Domen Podnar, që të themelohet një odë që përfaqëson mjekët e Kosovës. Prapa neve qëndronin fuqimisht institutet ku ne punonim në atë kohë: Universiteti i Mannheim-it, Klinika e Kirurgjisë me shefin tim atëherë Prof. Dr. Stefan Post që më dha dritën jeshile. Berlina morri përsipër koordinimin e punës. Së pari caktuam për në shtator të 2010 shumë takime në Kosovë si me Ambasadorin

gjerman; me Dr. Bujar Bukoshin, Ministër i Shëndetësisë; Dr. Shaip Mujën, Bordin udhëheqës të QKUK-së, IKSHPK, Zyrën e BE-së në Prishtinë; Shoqatën e Kirurgëve të Kosovës, etj.

Në ndërkohë, ra Qeveria e Kosovës dhe disa muaj më vonë u themelua Qeveria e re (janar 2011) dhe Ministër i ri i Shëndetësisë u caktua Prof. Dr. Ferid Agani. Ai u zotua se projekti për Odën do të finalizohet me themelimin e OMK-së.

Ministri Agani u ftua nga Berlina (Bundesärztekammer - Oda Federative e Mjekëve) dhe ishte mysafir special në Kuvendin e 114-të të Odës Federative të Mjekëve të Gjermanisë që u mbajt në Kiel, 31 maj-3 qershor 2011. Aty jam takuar të parën herë me ministrin Agani dhe si ndërmjetësues ia kam komunikuar miqësisht gjithë vullnetin fisnik dhe interesin miqësor gjerman, e mbi të gjitha domosdoshmërinë e një ode të mjekëve në Kosovë.

Viti 2011 dhe 2012 na ka kushtuar shumë punë në Kosovë e Gjermani. Kulmi i kësaj ishte Simpoziumi në Emerald Hotel me prezencën e Prof. Frank Montgomery, kryetar i Bundesärztekammer, Prof. Stefan Post, drejtor i Klinikës Universitare të Kirurgjisë në Mannheim, Univerziteti i Heidelberg-ut, Dr. Rudolf Henke, delegat në Bundestag-un gjerman dhe njëkohësisht kryetar i Marburger-Bund-it - Sindikatës së mjekëve në Gjermani, Dr. Ottmar Kloiber, Sekretari gjeneral i Organizatës Botërore të Mjekëve me seli në Gjenevë, shumë mysafirë të tjerë nga Gjermania, Ambasadori gjerman në Kosovë dhe, natyrisht Dr. Ramin Parsa-Parsi, Domen Podnar dhe Dr. Salih Berisha.

Ka qenë një periudhë intensive pastaj e krijimit të bazës ligjore dhe dokumenteve të tjera për odën. Këtu, pra në Berlin është gdhendur Ligji dhe statuti i OMK-së. Kompatibilitetin e tij me Kushtetutën e Kosovës dhe kodin civil e penal të saj si dhe kompatibilitetin me ligjet përkatëse evropiane e kemi studiuar në detaje me dy juriste gjermane në Berlin, duke mos lënë vend për keqinterpretime.

Në qershor 2013 Ligji për Odat e Professionistëve Shëndetësor është miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe pastaj është dekretuar nga Presidentja e Kosovës. Pjesa tjetër pastaj ka vazhduar me mbajtjen e zgjedhjeve dhe Kuvendin themelues të OMK-së ku më 17 tetor u mbajtën zgjedhjet për Kuvendin e OMK-së në nivel të institucioneve, ndërsa më 10 nëntor, prof. dr. Zylfije Hundozi është zgjedhur kryetare e parë e OMK-së në një Kuvend me pjesëmarrje të anëtarëve të Kuvendit të Odës dhe delegacioneve të larta nga odat respektive nga Gjermania dhe shumë shtete të tjera.

Natyrisht, gjatë kësaj kohe ka pasur edhe periudha jo të frytshme e telashe në bartje kompe-

Korrespondenca:
salih.berisha@grn.de

tencash, por Oda vazhdoi tutje dhe më 1 dhjetor 2017, dr. Pleurat Sejdiu u zgjodh kryetar i ri i OMK-së, pasi prof. Hundozi përfundoi mandatin dhe nga ky kuvend zgjedhor edhe ne kemi dalë optimist për zhvillimin e mëtejme të OMK-së.

Si e vlerësoni zhvillimin e deritanishëm të OMK-së dhe, sipas jush, cilat janë të arriturat e saj?

Vështrimet i bëj nga shtypi dhe opinioni publik ose përmes kontakteve personale. Në përgjithësi më pëlqejnë goxha shumë, sepse është bërë punë e madhe dhe substanciale.

Duke pasur parasysh vështirësitë me të cilat ballafaqohet një organizatë e lindur 'sui generis' si ajo e OMK-së dhe OMK-së gjermane që është më shumë se 120 vjet e vjetër, ka qenë një bashkëpunim frytdhënës dhe mbresëlënës edhe-pse duhet ende shumë punë për t'u bërë.

Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohet sot OMK, sipas jush, çka do të kishit sugjeruar për zhvillimin e mëtejme të Odës dhe, cila do të duhej të ishte e ardhmja e saj?

Stabilizimi i saj, perceptimi i saj si organizata e vetme dhe më e fuqishme për organizmin profesional të mjekëve në ritjen, ruajtjen dhe mbrojtjen profesionale të identitetit akademik mjekësor. Gjithashtu, prania e saj në çdo tablo dhe takim vendimmarrës që prek interesat e mjekëve; rregullimi dhe kontrollimi i edukimit dhe trajnimit profesional në mënyrë të vazhdueshme i anëtarëve të saj; rritja e kapaciteteve infrastrukturore e njerëzore brenda OMK; komunikimi me shoqërinë civile dhe kontaktet e vazhdueshme me ta për një shoqëri të shëndoshë e të emancipuar...

Duke qenë bashkëthemelues i kësaj ode fisnike, kurrë nuk më hyn mendja të mos jem i gatshëm të bashkëpunoj me të. Dëshira për ta parë sa më profesionale dhe të madhëruar atë Odë është aq dominuese sa që nuk e di çka do duhej të ndodhte për të mos këmbyer përvojën time/tonën me OMK-në.



Legjislatura e parë e Kuvendit të Odës së Mjekëve të Kosovës

PUNA PËR PACIENTËT NË KOSOVË - VETQEVERISJA SOLIDE MJEKËSORE NXIT CILËSINË NË KUJDESIN SHËNDETËSOR



Ramin Parsa- Parsi

Një nga iniciatorët dhe kontribuesit për themelimin e OMK-së

Shefi i departamentit të Shoqatës Mjekësore Gjermane

Vetëqeverisja bazohet në kornizën e parashikuar nga ligjvënësi. Atyre të cilëve u është besuar vendosja e sistemit të vetëqeverisjes – gjegjësisht, vetë profesioni i mjekësisë – janë ata që i formësojnë dhe zhvillojnë vazhdimisht strukturat të konsideruara të nevojshme dhe të përshtatshme.

Nuk kishte siguri se në Kosovë do të vendosej korniza ligjore për vetëqeverisje në sistemin shëndetësor. Megjithatë, 10 vjet pas krijimit të Odës së Mjekëve, ka prova të pamohueshme se ajo është një storje suksesi. Kur profesionistëve shëndetësorë u jepet një zë përfaqësues dhe u caktohen detyra të rëndësishme, kjo e lehtëson qeverinë dhe administratën kombëtare prej shumë detyrave organizative dhe arsimore në lidhje me profesionin mjekësor, forcon profesionalizmin mjekësor dhe edukimin mjekësor pasuniversitar, si dhe rrit cilësinë e ofrimit të kujdesit shëndetësor.

Nuk është detyrë e lehtë të bashkoh njerëz me pikëpamje dhe përgjegjësi të ndryshme, dhe lufta për të gjetur zgjidhje të përbashkëta mund të jetë gjithashtu e lodhshme. Përkundër këtyre sfidave, vetëqeverisja është dëshmuar të jetë një qasje shumë e qëndrueshme në Kosovë.

Ishte një vendim largpamës nga Ministri i atëherëshëm i Shëndetësisë që të dëgjonte zëra të ndryshëm, të merrte në konsideratë sistemet e provuara evropiane të vetëqeverisjes, si dhe që menaxhimin e detyrave të caktuara t'ua besonte palëve të përkushtuara të interesit dhe ofruesve të shërbimeve në sektorin e shëndetësisë. Kjo jo vetëm që i ka forcuar profesionet shëndetësore, madje edhe sistemin shëndetësor në tërësi, por edhe i ka bërë një shërbim të madh shoqërisë kosovare. Në të njëjtën kohë, ministri ka përqaftuar një koncept për organizimin e profesionistëve shëndetësorë, i cili tashmë është dëshmuar të jetë efektiv në Gjermani, Poloni, Austri, si dhe në shumë vende fqinje më të afërta. Kosova u bë pjesë e një tradite më të gjerë rajonale.

Në vetëm pak vite, Oda e Mjekëve është bërë akter i fuqishëm në Kosovë, duke përfaqësuar me besim mjekët e vendit dhe duke marrë pjesë aktive në takimet evropiane dhe ndërkombëtare.

Në fillim të procesit, ministri i atëherëshëm i Shëndetësisë së Kosovës, profesor Ferid Agani, zyrtarisht kërkoi nga Shoqata e Mjekësisë Gjermane që të ofrojë udhëzime dhe mbështetje përmes procesit të themelimit të Odës së Mjekëve. Nga këndvështrimi ynë, diskutimet e shumta që patëm me ministrinë krijuan një bazë të mirë për hartimin e kornizës ligjore dhe vendosjen e një sistemi të vetëqeverisjes mjekësore në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm edhe me organe të ndryshme në Kosovë dhe me përfaqësues të tyre, si ambasadoren gjermane në Republikën e Kosovës,

përfaqësues të Përfaqësuesit të Posaçëm të Bashkimit Evropian në Kosovë, deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe përfaqësues nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës.

Në secilën vizitë në Kosovë që nga viti 2010, ka pasur konsultime me Ministrin e Shëndetësisë dhe stafin përgjegjës në ministri për një sërë temash, nga ecuria e zbatimit të Odës së Mjekëve, deri te trajnimi i mjekëve dhe edukimi i vazhdueshëm mjekësor (EVM) në Gjermani.

Për shembull, në përgatitje për ngritjen e odave të ndryshme, Ministria e Shëndetësisë organizoi një takim me rreth 50 profesionistë shëndetësorë. Shoqata e Mjekësisë Gjermane pati privilegjin të merrte pjesë gjithashtu në takim dhe mbështeti 15 përfaqësuesit e zgjedhur të mjekëve të pranishëm në punën e tyre të ardhshme. Në vitin 2012, ministri Ferid Agani na ofroi edhe një turne informativ në Kosovë. Ne vizituam objektet shëndetësore në Pejë, Prizren, Prishtinë, Mitrovicë dhe Gjilan për t'i ofruar profesionit mjekësor dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë informacione rreth sistemit të vetëqeverisjes mjekësore dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe shqetësimeve. Zbatimi i suksesshëm i vetëqeverisjes kërkon mbështetjen dhe vlerësimin e plotë të profesionit përkatës.

Prandaj, ishte jo vetëm një nder i madh për ne që ishim pjesë e këtij delegacioni, por edhe një hap i domosdoshëm drejt ndërtimit të besimit në këtë sistem mes profesionistëve të mjekësisë në Kosovë. Ne ishim gjithashtu në gjendje të ofrojmë ekspertizën dhe mbështetjen tonë në lidhje me zbatimin e strukturave të vetëqeverisjes mjekësore dhe të ofrojmë një linjë komunikimi me Ministrinë Federale të Shëndetësisë në Gjermani.

Në fund, megjithatë, ishin palët e interesit në Kosovë ata që duhej të gjenin rrugën e tyre për të krijuar një kornizë të përshtatshme për të përmbushur nevojat unike të profesionit të tyre mjekësor.

Para pandemisë Covid-19, ministrat e Shëndetësisë, profesor Ferid Agani, Imet Rrahmani dhe Uran Ismaili, kishin marrë pjesë në Asamblenë Mjekësore në Gjermani. Gjatë këtyre asambleve, ne mundëm të organizonim biseda ose takime me ministrat federalë gjermanë të shëndetësisë, Hermann Gröhe dhe Jens Spahn. Shkëmbimi zyrtar siguri dhe forcoi më tej bashkëpunimin mes nesh. Që në fillim, Ministria e Shëndetësisë dhe udhëheqja e saj ishin shumë të hapura ndaj idesë së vetëqeverisjes dhe bashkëpunimit me Shoqatën Mjekësore Gjermane. Ne e vlerësuam shumë këtë bashkëpunim të frytshëm dhe plot besim, çka lejoi një dialog të hapur dhe të ndershtëm.

Kjo nuk do të thotë se nuk ishte sfiduese për ministrinë që të menaxhonte delegimin e detyrave. Dhe nuk duhet harruar se brenda sistemit kishte edhe konservatorë që ishin

skeptikë për një transferim të tillë pushteti.

Procesi i vetëqeverisjes është një punë e vazhdueshme në progres. Kjo kërkon një odë të fortë që mbetet partner i rëndësishëm për qeverinë dhe për të mbrojtur interesat dhe nevojat në zhvillim të mjekëve dhe më e rëndësishmja të pacientëve tanë.



Gjatë Kuvendit konstitutiv të legjislacionit të parë, 2013



VETËQEVERISJA KËRKON NJË PROFESION MJEKËSOR ME VETËBESIM



Domen Podnar

Një nga iniciatorët dhe kontribuesit për themelimin e OMK-së

*Këshilltar për politikë,
Departamenti për çështje
ndërkombëtare,
Shoqata Gjermane e Mjekësisë*

Kur një delegacion i vogël i Shoqatës së Mjekësisë Gjermane (GMA) udhëtoi për herë të parë në Kosovë në vitin 2010, nuk e dinim se cili do të ishte rezultati. Iniciativa për vizitën e parë ishte e dyfishtë. Nga njëra anë, disa anëtarë dhe organizata të përkushtuara të profesionit të mjekësisë gjermane, duke përfshirë edhe Fondacionin Hans Neuffer, i cili është i lidhur ngushtë me GMA, kërkuan nga Departamenti për Çështje Ndërkombëtare i GMA-së informacione për mënyrën e organizimit të profesionit mjekësor në Kosovë. Nga ana tjetër, kishte gjithnjë e më shumë kërkesa nga anëtarët tanë për edukimin bazë mjekësor, trajnimin e specialitetit, edukimin e vazhdueshëm mjekësor (EVM) dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional (ZHVP) të mjekëve migruar nga Kosova, gjë që na bëri të kuptojmë se nuk e kishim një kontakt me profesionin mjekësor në Kosovë me të cilin mund të shkëmbejmë informacione.

Në Gjermani, Odat Shtetërore të Mjekëve janë përgjegjëse për lëshimin e diplomave mjekësore të specializuara. Shoqata e Mjekësisë Gjermane, si grupi punues i Odave Shtetërore të Mjekëve në Gjermani, u ndihmon anëtarëve të saj me kontakte dhe informacione rreth strukturave të ndryshme të profesionit mjekësor dhe sistemeve të kujdesit shëndetësor jashtë vendit. Prandaj, qëllimi fillestar i vizitës sonë ishte të mësojmë më shumë rreth profesionit mjekësor në Kosovë.

Pas leximit të një artikulli në revistën kryesore mjekësore të GMA, Deutsches Ärzteblatt, rreth eventeve për EVM nga Universiteti i Mannheim në Prishtinë, ne kontaktuam bashkë-organizatorin e eventeve, Dr. Salih Berishën, dhe planifikuam një vizitë së bashku në Kosovë në vitin 2010. Dr. Berisha mblodhi së bashku një grup të vogël mjekësh të cilët u takuan me ne për të na shpjeguar situatën me të cilën përballen mjekët në Kosovë dhe mënyrën se si është organizuar profesioni. Diskutimet fillestare u zhvilluan edhe me vendimmarrësit politikë që ishin kontakte të Dr. Berishës. Këto diskutime u bënë më të thelluara me kalimin e kohës dhe u pasuan nga një event i përbashkët për EVM për mjekët kosovarë në Prishtinë në vitin 2011, i cili tërhoqi rreth 300 pjesëmarrës. Ai kishte për qëllim që të tregojë spektrin e gjerë të vetëqeverisjes mjekësore për profesionin e mjekësisë në Kosovë.

Biseda me vendimmarrësit politikë ishte një aspekt i rëndësishëm, por ishte edhe më e rëndësishme që mjekët të fitonin konceptin e vetëqeverisjes mjekësore dhe t'u tregojë se u takon atyre të marrin përgjegjësinë për profesionin e tyre dhe pacientët. Pa mjekë të përkushtuar, vetëqeverisja mjekësore nuk mund të ketë sukses. Pasi Ministria e Shëndetësisë kërkoi zyrtarisht mbështetje për ngritjen e strukturave vetëqeverisëse në Kosovë, një pjesë e punës sonë përfshinte motivimin dhe këshillimin e mjekëve që do të ishin pjesë përbërëse e themelimit të

këtyre strukturave. Ne arritëm shumë së bashku me Dr. Berishën, Fondacionin Gjerman Hans Neuffer dhe LuxDev, të cilët luajtën një rol vendimtar në zhvillimin e kornizës financiare në konsultim me GMA-në.

Një rezultat i suksesshëm, për shembull, ishin sesionet e trajnimit të mbajtura në selinë e GMA-së në Berlin, të drejtuara ndaj profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë në Kosovë dhe të fokusuar në procesin e themelimit të odave të ndryshme të profesionistëve shëndetësorë. Programi përfshinte ligjëratë nga ekspertë të GMA-së, si dhe një vizitë në Odën e Mjekëve të Berlinit. Fokusi në Odën e Mjekëve të Berlinit ishte në kërkesat organizative dhe zbatimin e detyrave të një ode të mjekëve. Kontributi i ish Sekretares së Përgjithshme të Odës Shtetërore të Mjekëve të Saksonisë, Dr. Verena Diefenbach, dhe një përfaqësuesi të departamentit ligjor të odës, i cili dha një pasqyrë të përvojës së ngritjes së strukturave të odës në Saksoni në fillim të viteve 1990, dëshmoi të jetë jashtëzakonisht i vlefshëm. Akti për Odën e Profesioneve Shëndetësore në Saksoni u rekomandua si shabllon për ligjet në Kosovë. Gjithashtu u vunë në dispozicion përkthimet në shqip të teksteve të rëndësishme juridike gjermane dhe të themeleve të tjera ligjore të Odës Shtetërore të Mjekëve të Saksonisë.

Në të njëjtin vit, turneu i përbashkët nëpër spitale rajonale të vendit me Ministrin e Shëndetësisë së Kosovës, Prof. Ferid Agani, shërbeu për të forcuar përkushtimin e mjekëve në ndërtimin e odës së tyre. Në një takim prej katër orësh me përfaqësues të profesioneve shëndetësore, më pas diskutuam për hapat e mëtejshëm të këtij procesi.

Ne u takuam edhe me komisionin zgjedhor përpara zgjedhjeve të para të Odës së Mjekëve dhe na la përshtypje se sa profesionalisht e kryen punën e tyre dhe sa shumë pritje kishin në prag të këtyre zgjedhjeve. Me rastin e kuvendit së parë të odës, organizuam konferencë me pjesëmarrës ndërkombëtarë. Ishte ngazëlluese të shihje se sa përfaqësues ndërkombëtarë nga rajoni shprehën mbështetjen e tyre për punën e ardhshme të Odës së Mjekëve të Kosovës. Ishte një moment solemn kur u zgjodh kryetarja e parë e Odës së Mjekëve të Kosovës, Dr. Zylfije Hundozi, çka u kremtua me një tubim të madh.

Ishte e rëndësishme që profesioni i mjekësisë të vihej në pozicionin që të organizohej vetë. Pa këtë dhe pa përkushtimin e lidershit, përfshirë Dr. Zylfije Hundozin dhe Dr. Pleurat Sejdiun, kjo nuk do të ishte e mundur. Në këtë proces kemi vërejtur se rezistenca e Ministrisë ka qenë mjaft e fortë kur është paraparë se cilat detyra do të merren oda e mjekëve. Në vitet e para, u harxhuar shumë energji me këto mosmarrëveshje. Në fakt, ato ndikuan fuqishëm në mandatin e Dr. Hundozit në detyrë. Dr. Hundozi ishte shumë e përkush-

tuar dhe mbrojtje idenë e vetëqeverisjes së profesionit mjekësor. Megjithatë, mosmarrëveshjet luajtën një rol të rëndësishëm në forcimin e vullnetit të odës për të formësuar fatin e saj dhe për të siguruar burime esenciale financiare. Përkundër këtyre sfidave, zgjedhjet e dyta të odës u zhvilluan me sukses dhe profesionalizëm pas mandatit katërvjeçar. Kjo shenjë e vazhdimësisë dhe angazhimi këmbëngulës i Dr. Pleurat Sejdiut më pas çoi në konsolidimin e punës së Odës së Mjekëve, delegimin e mëtejshëm të detyrave dhe rritjen e profesionalizimit të organizatës. Më bëri shumë përshtypje gjatë një vizite në vitin 2019 se sa është rritur ekipi në zyrë dhe konkretisht sa stafi i ri, i përkushtuar dhe i mirëtrajnuar ishte rekrutuar për punën e odës së mjekëve. Sigurisht që këtu duhet të merret parasysh gjithmonë mbështetja nga Dr. Afërdita Ademi prej LuxDev, si dhe nga Dr. Berisha.

Ka pasur fokus të madh edhe në integ-

rimin e Odës së Mjekëve të Kosovës në organizmat evropiane dhe të tjera ndërkombëtare. Për shembull, përfaqësues të Odës së Mjekëve janë ftuar rregullisht nga GMA në Asambljetë vjetore të Mjekësisë Gjermane, si dhe në takimet e Odave të Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Lindore, të njohura si Simpoziumi vjetor ZEVA. Oda e Mjekëve të Kosovës pati gjithashtu një arritje të rëndësishme kur iu dha statusi i vëzhguesit në Komitetin e Përhershëm të Mjekëve Evropianë (CPME).

Nëpërmjet punës së palodhur të mjekëve të përkushtuar brenda dhe jashtë organeve të odës, u krijua një odë e fortë mjekësore, e cila vazhdon të kontribuojë me zërin e saj si brenda vendit ashtu edhe në nivel evropian. Gjatë gjithë këtyre viteve, ka qenë e jashtëzakonshme të shihet se si është rritur përkushtimi i mjekëve që nga ndërtimi i strukturave. Marrë parasysh strukturat më të dobëta të shoqërisë civile që ata kishin

përjetuar në të kaluarën, mjekët dhe udhëheqësit e tyre e kuptuan shumë shpejt dhe në mënyrë të qëndrueshme rëndësinë e formimit të një organizate të pavarur, me vetëbesim, e cila përfaqëson mjekët dhe mbështetësit e pacientëve. Mjekët e Kosovës e kanë shfrytëzuar mundësinë e tyre dhe kanë krijuar një zë të fortë dhe jam i sigurt se kjo do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Urime për 10 vjetorin e Odës së Mjekëve të Republikës së Kosovës: Duhet të jeni krenarë për punën tuaj.



Vizitë e përfaqësuesit nga Shoqata Gjermane Mjekësore në Odën e Mjekëve të Kosovës



Kryetari i Odës së Mjekëve, Dr. Pleurat Sejdiu ndanë mirënjohje për përfaqësuesin Shoqatës Gjermane Mjekësore, z. Domen Podnar

OMK ËSHTË DUKE E PËRMBUSHUR MISIONIN DHE PËRGJEGJËSITË E SAJ



Zylfije Hundozi

Kryetare e parë e Odës së Mjekëve të Kosovës,

Kryetarja e parë e Odës së Mjekëve të Kosovës, Prof. Dr. Zylfije Hundozi thotë se kur kishte kandiduar për këtë detyrë, qëllimi i saj ishte që të kontribuoj në ndërtimin e një institucioni ku mjekët do të kenë pavarësinë e plot në rregullimin e çështjeve në punën e tyre, por njëherësh dhe të bashkëpunojnë me institucionet e tjera relevante për t'i realizuar gjer në fund detyrat dhe përgjegjësitë e parapara me ligj.

Cila ishte ndjenja të jeni kryetare e parë e Odës së Mjekëve të Kosovës?

Gjatë punës shumë vjeçare në shëndetësi kam pasur përvoja dhe sfida të ndryshme. Ngjarjet të cilat kanë pasur ndikim të jashtëzakonshëm në mjekësinë kosovare kanë qenë ato të fillimit të viteve të 90-ta. Në fillim të këtyre viteve mjekësia kosovare ka pësuar një grusht të madh nga regjimi i atëhershëm i Millosheviqit, i dhënë me qëllim të shkatërrimit të mjekësisë kosovare. Nga ky regjim u përjashtuan nga puna një numër i madh i mjekëve shqiptarë që ishin shumica e mjekëve në institucionet shëndetësore. Me këtë rast, nga shumica e klinikave të QKUK u përjashtuan 90 për qind të mjekëve, ndërsa në klinikat si Gjinekologjia, Kirurgjia dhe Interno mbetën pa mjekë shqiptarë. Të gjithë mjekët shqiptarë e kanë përjetuar rëndë këtë sulm ndaj institucioneve mjekësore, prandaj me rastin e zgjedhjes sime kryetare e Odës së Mjekëve të Kosovës e ndjeva veten të privilegjuar, që po më jepej rasti të kontribuojë në ndërtimin e një institucioni të ri mjekësor të pavarur ku mjekët do të kenë mundësinë të vendosin për punën, edukimin e vazhdueshëm dhe ardhmërinë e vet. Në ato momente ndihesha që mua dhe kolegëve tjerë të OMK po u jepej rasti për të përmirësuar një padrejtësi që na është ishte bërë neve mjekëve me rastin e largimit nga institucionet publike, por njëherësh të vendosim në mënyrë të pavarur tash e tutje për punën dhe të gjitha çështjet e tjera me rëndësi për mjekët e Kosovës.

Pra, të them shkurt ishte ndjenjë e gëzimit dhe e përgjegjësisë për krijimin e një institucioni të ri me rëndësi të madhe në mjekësinë kosovare.

Çka ju kishte shtyrë që të konkurrioni për këtë detyrë dhe si ishin hapat e parë në ngritjen e OMK-së, duke qenë se si organizatë ishte e re në Kosovë?

Disa specialistë të klinikës së Neurologjisë kishin ardhur të bisedojnë me mua, duke më sugjeruar që të kandidojë për kryetare të OMK. Nuk ju kam dhënë përgjigje fillimisht, duke ju premtuar se së pari do ta lexoja Ligjin për Odat e profesionistëve shëndetësor, pasi OMK nuk ka ekzistuar më parë dhe nuk kam qenë e njoftuar se çka pritet prej kryetarit të OMK.

Pas leximit të ligjit në të cilin ishin qartë të për-

caktuara detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e kryetarit, por edhe të gjithë anëtarëve të tjerë pranova që të kandidojë. Pra, qëllimi im ishte që të kontribuoj në ndërtimin e një institucioni ku mjekët do të kenë pavarësinë e plot në rregullimin e çështjeve në punën e tyre, por njëherësh dhe të bashkëpunojnë me institucionet e tjera relevante për t'i realizuar gjer në fund detyrat dhe përgjegjësitë e parapara me ligj.

Si e vlerësoni zhvillimin e deritanishëm të OMK-së dhe, sipas jush, cilat janë të arriturat e saj?

Zhvillimin e deritashëm të OMK i shoh në mënyrë pozitive. OMK ka arritur të funksionojë me gati të gjitha kompetencat e saj, pos specializimeve, të cilat me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor i takojnë asaj. Shpresoj që të ardhmen ta kryej edhe këtë funksion.

A është duke e përmbushur OMK misionin dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligj?

Po, OMK është duke e përmbushur misionin dhe përgjegjësitë të cilat i takojnë me ligj.

Cilat, sipas jush, janë sfidat me të cilat është ballafaquar OMK në vitet e para të ngritjes e fuqizimit të saj dhe cilat janë tani?

Në vitet e para të funksionimit të saj, OMK ka pasur sfida të shumta. Për tre vjetet e parë, buxheti i OMK ka qenë i alokuar në Ministrinë e Shëndetësisë me kusht që ai buxhet t'i jepet në ndërkohë OMK-s në shfrytëzim. Mirëpo as në katër vitet e funksionimit të OMK, ai buxhet nuk i është dhënë OMK me pretekste dhe kërkesa të ndryshme për profesionistët shëndetësor. Është harxhuar shumë kohë dhe mund për t'i plotësuar kërkesat e Ministrisë, por buxheti i dedikuar për OMK nuk i është dhënë asnjëherë në shfrytëzim. Unë dhe anëtarët e OMK për 4 vjet rresht kemi punuar në baza vullnetare. Për shkak të mungesës së buxhetit nuk kemi pasur staf administrativ e as jurist, por të gjitha rregulloret, Statutin dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor e kemi përpiluar vet. Duhet të përmendet puna pa lodhshme dhe përkushtimi pa rezervë i anëtarëve të Këshillit drejtues, anëtarëve të komisioneve dhe krejt anëtarëve të Kuvendit të OMK-së, për përkushtimin e madh për funksionalizimin e këtij institucioni. Vullneti dhe dëshira shumë e madhe që ta kemi një institucion tonin të pavarur ka bërë që të gjithë mjekët t'i japin përkrahje të pa kontestueshme OMK-së.

Puna jonë dhe përkushtimi për ngritjen e organeve të OMK-së nuk ka pasur përkrahjen e Ministrisë së Shëndetësisë, por përkundrazi refuzimin e vazhdueshëm për bartjen buxhetit dhe kompetencave publike që me ligj i kanë takuar OMK edhe pse vazhdimisht i kemi plotësuar të gjitha kriteret të parapara me ligj. Me gjithë refuzimin

dhe trysinë negative që i është bërë, OMK ajo ka vazhduar të ekzistojë dhe ka arritur të vazhdojë punën e saj, ashtu qysh e ka paraparë Ligji për profesionistët shëndetësor gjer në ditën e sotme.

Çka do të kishit sugjeruar për zhvillimin e mëtejshëm të Odës dhe cila do të duhej të ishte e ardhmja e saj?

OMK gjer më tani ka punuar shumë mirë në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të parapara me ligj. Sugjerimi im do të ishte që zgjedhjet për anëtarët e Kuvendit të OMK në të ardhmen të jenë më transparente dhe të largohen mangësitë që e kanë përcjellë këtë proces. Kjo gjë do ta rriste besimin në OMK dhe organet e saj dhe do ta çojë drejt sukseseve edhe më të mëdha.

OMK ka nevojë për një objekt të punës ku do të ketë mundësi ta rris dhe zhvillojë edhe më tutje kapacitetin e saj si institucion i pavarur. Për këtë gjë kemi luftuar qysh në mandatin e saj të parë, duke i kontaktuar shumë donatorë që do të na ndihmonin në këtë drejtim pasi që mundësia materiale atëherë nuk ka ekzistuar.

OMK duhet të vazhdojë angazhimin e saj për bartjen e të gjitha kompetencave që i takojnë si-

pas ligjit. Konkretisht mendoj për specializimet, të cilat i takojnë me ligj, sepse përgjegjëse për specializime në të gjitha shtetet e Evropës janë odat respektive të mjekëve. Planifikimi i nevojave për numrin e mjekëve specialistë, përcaktimi i mentorëve që do t'i udhëheqin specialistët dhe plan-programet do të bëheshin më së miri nga ekspertët nga OMK.

Çka do të dëshironit të ndanit për lexuesit nga përvoja juaj si kryetare në një mandat e OMK-së?

Njëra nga përvojat e mia në krye të OMK është nga mbajta e kuvendit të dytë të OMK kur është mbajtur zgjedhja e anëtarëve të Këshillit drejtues dhe më pas të komisioneve të OMK.

Me këto zgjedhje mjekët kanë treguar një nivel të lart të kulturës demokratike. Në garën që është zhvilluar mjekët kanë treguar nivelin e lartë intelektual dhe moral që ishte shembull pozitiv për krejt shoqërinë kosovare. Gara demokratike dhe fer, pa hile që i ka shoqëruar këto zgjedhje ka krijuar një ndjenjë të krenarisë që jam mjeke dhe që jam pjesë e këtij komuniteti.

Mbresa pozitive që e kam përjetuar atë ditë jeton edhe këto ditë në mendjen time.



Përzgjedhja e kryetarës së parë të Odës së Mjekëve të Kosovës

OMK ISHTE SEGMENTI QË I MUNGONTE ORGANIZIMIT NË SHËNDETËSINË KOSOVARE



Imet Rrahmani

Ish - Ministër i Shëndetësisë

Oda e Mjekëve të Kosovës ishte segmenti i munguar i organizimit institucional, struktural dhe profesional në shëndetësinë kosovare. Kështu thotë ish-Ministri i Shëndetësisë Imet Rrahmani. Ai thekson se OMK sot duhet të vazhdojë të zhvillojë relacione të shëndosha me anëtarësinë e vet, për të shtuar besueshmërinë dhe kredibilitetin dhe se e ka detyrim ta mbajmë politikën jashtë organizimit dhe frymës së saj.

Si e vlerësoni zhvillimin e deritanishëm të OMK-së dhe, sipas jush, cilat janë të arriturat e saj?

OMK si institucion shumë vite ishte segmenti i munguar i organizimit institucional, struktural dhe profesional në shëndetësinë kosovare. Prandaj, vet ekzistimi i saj, organizimi i tanishëm dhe funksionimi në rrethanat ashtu çfarë janë, mund të konsiderohet si e arritur. Pastaj, OMK ka organizuar zgjedhjet dhe ka funksionalizuar organet e saja me sukses jo vetëm njëherë, ka krijuar një sistem licencimi dhe ri-licencimi që duhet vlerësuar, pa e harruar edhe angazhimin në adresimin e problemeve të mjekut, brenda kompetencave që i ka.

Cili ka qenë bashkëpunimi midis MSH dhe OMK-së gjatë mandatit tuaj si Ministër?

Stadi i zhvillimit të OMK-së dhe rrethanat në atë periudhë ishin me plot sfida, jo mjaftueshëm të mirëkuptuara, herë - herë edhe me debate shteruese, gjithmonë në funksion të gjetjes së zgjidhjeve më të mira brenda ligjit dhe kompetencave edhe të OMK-së edhe të MSH-së. Mbjaj mend se asnjëherë nuk ka munguar angazhimi nga ana e stafit në Ministri, përfshirë edhe pjesën politike, në krijimin e kushteve që OMK sa më shpejt të bëhet funksionale me kompetenca të plota sipas Ligjit për Odën e Profesionistëve Shëndetësor.

Cilat, sipas jush, janë sfidat me të cilat ballafaqohet sot OMK?

OMK ka kaluar një fazë të funksionimit me përvojë të munguar. Një dukuri që po e rëndon mbarë shoqërinë, largimi i mjekëve në vendet e tjera, duhet të trajtohet me projekt dhe aktivitete shumë specifike dhe konkrete, jo vetëm nga OMK, por edhe nga të gjitha institucionet vendimarrëse në vend. Pastaj, edhe OMK, krahas të tjerëve, do të duhej të ishte katalizator i programeve dhe ndërmarrjeve, i bashkëpunimit me organet e drejtësisë, shoqërinë civile dhe mediat, që të thyhet perceptimi tejet negativ për mjekët, dhe duke kontribuar në kthimin e besimit të ndërsjellë në relacionet mjek-pacient-institucione të shtetit.

Çka do të kishit sugjeruar për zhvillimin e mëtejshëm të Odës dhe cila do të duhej të ishte e ardhmja e saj?

OMK duhet të vazhdojë të zhvillojë relacione të

shëndosha me anëtarësinë e vet në radhë të parë, për të shtuar besueshmërinë dhe për të marr mbështetje, për të t'u shndërruar në institucion kredibil brenda komunitetit të mjekëve dhe në raportet me partner qeveritar dhe profesional. Dhe e fundit, e kemi detyrim ta mbajmë politikën jashtë organizimit dhe frymës së OMK-së.

Korrespondenca:
imetrrahmani@hotmail.com



OMK DHE UMSH ERDHËN SI RISI NË SHËNDETËSINË E KOSOVËS E SHQIPËRISË



Fatmir Brahimaj

Kryetar i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë

Kryetari i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë thotë dallimet që ekzistojnë në mes këtyre dy organizatave janë të kushtëzuara nga kuadri ligjor përkatës, që dallon në të dy vendet. Por në thelb, thekson ai, misioni si i OMK-së, ashtu edhe i UMSH-së është i njëjtë: ofrimi i Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, ruajtja e standardeve të larta profesionale, si dhe mbrojtja e publikut nga keq-ushtimi i profesionit mjekësor

Cilat ishin kontaktet e para të Urdhrit të Mjekut të Shqipërisë me Odën e Mjekëve të Kosovës?

Së pari dua të ju falënderoj për ftesën në këtë intervistë, duke më dhënë mundësi të shpreh, jo vetëm kënaqësi për këtë festë të përbashkët të 10 vjetorit të krijimit të OMK-së, por dhe për të ndarë disa mendime për punën, arritjet, sfidat për të ardhmen. Ne jemi jo vetëm të një profesioni, por edhe të një kombi dhe të një gjaku, prandaj i shohim gjërat si të përbashkëta, pavarësisht se dëshirat hera herës nuk përputhen me mundësitë që na krijohen.

Një vit para formimit të OMK, përfaqësues të Dhomës Mjekësore Gjermane erdhën në Tiranë dhe diskutuan me drejtues të UMSH-së të asaj kohe, idenë për krijimin e një organizmi profesional në Kosovë. Ata gjetën mbështetjen tonë për këtë ide (theksoj se edhe për UMSH-në Dhoma Mjekësore Gjermane ka qenë një faktor i rëndësishëm në hapat e para të veprimtarisë sonë). Gjatë atij viti kanë ardhur në Tiranë 2 herë përfaqësues të komisionit nismëtar të OMK për të diskutuar detaje për hapat e mëtejshme drejt kurorëzimit të kësaj nisme të rëndësishme për profesionin mjekësor në Kosovë. I gjithë dokumentacioni i UMSH-së u mor si model për të hartuar dokumentin bazë të OMK-së. Kontakti i parë zyrtar ishte pjesëmarrja në mbledhjen themeluese të Odës së Mjekëve në Prishtinë.

Si e vlerësoni zhvillimin e deritanishëm të OMK-së dhe, sipas jush, cilat janë të arriturat e saj?

Sigurisht si çdo fillim edhe për OMK ka pasur vështirësi të mëdha. Në vendet tona këto pengesa shumëfishohen nga mungesa e traditës, përvojës si dhe mentalitetit të së shkuarës, ku gjithçka ishte e përqendruar tek shteti. Sidoqoftë, me kalimin e viteve ecuria ka qenë pozitive, në favor të mjekëve, të vet-rregullimit profesional dhe mbrojtjes së publikut nga keq-ushtimi profesional mjekësor. Mbi të gjitha, vlerësoj faktin që kemi një organizëm profesional të vetëqeverisjes dhe vet-rregullimit të profesionit, të mbështetur në një kornizë ligjore. Edhe pse themelimi i OMK është i vonuar falë mbështetjes ndërkombëtare të homologëve dhe qeverisë të disa vendeve janë hedhur hapa të rëndësishëm dhe arritjet janë të lavdërueshme dhe të kënaqshme për kohën. Sigurisht ato që janë bërë në shekuj në vendet e tjera nuk mund të arrihen në ato nivele në intervale të shkurtra kohore.

Cili ka qenë bashkëpunimi midis Urdhrit të

Mjekëve të Shqipërisë dhe Odës së Mjekëve nga Kosova?

Këtu do të theksoj se është shfrytëzuar çdo kontakt ndërmjet nesh dhe OKM në pjesëmarrje, takime dhe veprimtari të dy palëve, kemi mbështetur njëri-tjetrin në takimet ndërkombëtare duke bërë lobim në favor tonin, të OMK dhe anasjelltas.

Çka kanë mundur të mësojnë këto dy organizata nga njëra -tjetra?

Të dyja këto organizma janë risi në sistemin shëndetësor të vendeve tona. Vështirësia e përbashkët midis realiteteve tona dhe nivelit të vetëqeverisjes dhe vet-rregullimit profesional në vendet e tjera na ka bërë të huazojmë nga njëri tjetri mënyrën e implementimit të praktikave profesionale që kuadri ligjor në të dy vendet na ka lejuar të implementojmë, me fjalë të tjera problematika të njëjta në realitete të ngjashme kemi mundësuar zbatime të përafërta.

A ka dallime të mëdha midis mënyrës si funksionon Urdhri në Shqipëri dhe OMK në Kosovë?

Patjetër ka dallime midis nesh të kushtëzuara nga kuadri ligjor përkatës, që dallon në të dy vendet. Por në thelb, misioni si i OMK-së, ashtu edhe i UMSH-së është i njëjtë: ofrimi i Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, ruajtja e standardeve të larta profesionale, si dhe mbrojtja e publikut nga keq-ushtimi i profesionit mjekësor.

Cilat, sipas jush, janë sfidat me të cilat ballafaqohet sot OMK?

Dua të rikujtoj se OMK është organizëm i ri në rritje dhe në zhvillim. Duhet bërë përpjekjet të shumta për përfaqësimin e legjislativitetit përkatës me atë evropian, po ashtu duhet punuar për të fituar besimin e plotë dhe autoritetin që i takon tek bashkësia e mjekëve, si dhe besimin e publikut në marrëdhëniet me të.

Cilat janë projektet e përbashkëta dhe në çka realisht mund ta gjejnë veten Urdhri dhe OMK në bashkëpunimet e ardhshme?

Këtë pyetje e vlerësoj në veçanti pasi mendoj se ka ardhur koha që bashkëpunimi të jetë në një nivel tjetër, më i ngushtë dhe me më shumë veprimtari dhe projekte të përbashkëta.

Çka do të kishit sugjeruar për zhvillimin e mëtejshëm të Odës dhe cila do të duhej të ishte e ardhmja e saj?

Insistim të vazhdueshëm për të marrë të gjithë kompetencat që i takon një organizmi të tillë thelbësisht profesional e të pavarur. Realizimi në vazhdimësi i objektivave afatshkurtra dhe ato të perspektivës do të sigurojnë një të ardhme të suksesshme të ngjashme me homologët ndërkombëtarë.

A dëshironi të ndani ndonjë përvojë tuaj personale nga eventet e organizuara nga OMK gjatë

Korrespondenca:
albmedorder@albbmail.com

këtyre viteve?

Përvojat e përbashkëta gjithmonë më kanë dhënë kënaqësi. Çdo veprimtari na mëson diçka të re, prandaj jam ndjerë i privilegjuar duke marrë pjesë në shumë veprimtari të OMK-së. Do të veçoj takimin e majit 2018 në Prishtinë ku u diskutua mbi tema mjaft delikate, të ndjeshme për bashkësinë e mjekëve dhe akoma të pazgjidhura siç duket, atë për ndarjen e gabimit mjekësor nga neglizhenca mjekësore. Një takim i mirë organizuar dhe mjaft i frytshëm që më ka lënë mbresa të veçanta.



Kryetarët e OMK-së dhe UMSH-së gjithmonë bashkë

SHKRIM NGA ODA E MJEKËVE TË KROACISË



Oda e Mjekëve të Kroacisë

Oda Mjekësore e Kroacisë gjithmonë përpiqet të ofrojë mbështetje dhe të inkurajojë bashkëpunimin e suksesshëm me odat dhe organizatat ndërkombëtare mjekësore. Andaj, në nëntor të vitit 2013, Oda e Mjekësisë Kroate e pranoi me kënaqësi ftesën për Kuvendin Themelues të Odës së Mjekëve të Kosovës, i cili u mbajt në Prishtinë, Kosovë, ku Dr. Zylfije Hundozi u zgjodh kryetare e parë e Odës së Mjekëve të Kosovës.

Pas kuvendit, Shoqata e Mjekësisë Gjermane organizoi një seminar për organizimin e mjekëve, marrjen e një roli aktiv në vendimmarrje, kujdesin për pacientët, si dhe hapat e pritur nga oda e sapokrijuar.

Që atëherë, Oda e Mjekëve të Kosovës është bërë anëtare dhe partnere e respektuar e shoqatave të shumta ndërkombëtare mjekësore në takimet e të cilave marrin pjesë aktivisht përfaqësues të Odës së Mjekëve të Kosovës.

Veç kësaj, Oda e Mjekëve të Kosovës është vetë organizatore e diskutimeve të ekspertëve lidhur me profesionin mjekësor. Kështu, në vitin 2018, Oda Mjekësore e Kroacisë e pranoi me kënaqësi ftesën e Odës së Mjekëve të Kosovës për të marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët "Përgjegjësia profesionale, etike dhe penale – kufizimet dhe sfidat", në të cilën përfaqësuesja e Odës Mjekësore Kroate, as.prof. Marija Periq prezantoi kornizën legjislative kroate, rregulloret dhe pro-

cedurat në lidhje me përgjegjësinë profesionale të mjekëve.

Krahas zhvillimit profesional të mjekëve dhe profesionit mjekësor, Oda e Mjekëve të Kosovës investon edhe në zhvillimin dhe përmirësimin e proceseve dhe burimeve të veta njerëzore, duke grumbulluar përvojat e organizatave "më të vjetra" mjekësore. Kështu, në tetor dhe nëntor 2022, Oda Mjekësore e Kroacisë mirëpriti vizita studimore të delegacioneve nga Oda e Mjekëve të Kosovës me qëllim të shkëmbimit të përvojave. Zyrtarë dhe profesionistë të Odës Mjekësore të Kroacisë prezantuan para kolegëve të tyre kosovarë proceset organizative dhe teknologjike, projektet, aktet dhe procedurat ligjore, si dhe përfitimet që Oda e Mjekësisë e Kroacisë u ofron anëtarëve të vet.

Të dyja vizitat u zhvilluan me ndërveprim intensiv, i cili për kënaqësi reciproke rezultoi në shkëmbimin e informacioneve dhe përvojave të dobishme, të gjitha me qëllim të forcimit të rolit të Odës së Mjekëve të Kosovës.

Oda Mjekësore e Kroacisë e mbështet këtë lloj bashkëpunimi që do të kontribuojë në përmirësimin e odave të mjekësisë dhe në këtë mënyrë në përmirësimin e profesionit mjekësor dhe reputacionit të mjekëve.

Pranoni urimet tona për Odën e Mjekëve të Kosovës për 10 vjetorin e saj të rëndësishëm!



Vizita studimore e stafit profesional të OMK-së në Odën e Mjekëve të Kroacisë

DHJETË VJET RRUGËTIM- KRIJIMI DHE ZHVILLIMI I ORGANIZATAVE TË SUKSESSHME PROFESIONALE- HISTORIA E MBËSHTETJES SË ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS



Afërdita Ademi- Osmani

Këshilltare teknike kryesore e Projektit Lux Dev për Shëndetësi në Kosovë (Luxembourg Development Cooperation Agency)

Për një dekadë, Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit të sektorit shëndetësor në Kosovë, duke përfshirë themelimin e institucioneve të reja të dala nga procesi i reformës në sektorin e shëndetësisë. Përmes investimeve strategjike dhe bashkëpunimit të ngushtë, Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut, përmes Agjencisë së Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor në Kosovë - LuxDev, (projektet KSV/014 dhe KSV/017), ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në hartimin e politikave dhe rregulloreve për menaxhimin e kujdesit shëndetësor. Gjithashtu, ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore të nevojshme për funksionimin e suksesshëm të institucioneve shëndetësore.

Një nga fushat kyçe të fokusit të Bashkëpunimit Zhvillimor të Luksemburgut, ka qenë krijimi i kapaciteteve të nevojshme për funksionalizimin e institucioneve të reja që dalin nga përpjekjet për reformën e kujdesit shëndetësor, me theks të veçantë funksionalizimin e Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK).

Bashkëpunimi Zhvillimor i Luksemburgut ka qenë një aktor kryesor në ndihmën për zhvillimin e legjislacionit për krijimin e Odave të Professionistëve Shëndetësorë (OPSh), duke kontribuar në funksionalizimin e plotë të këtyre institucioneve të reja në Kosovë. Ky angazhim ka përfshirë ofrimin e asistencës teknike, bashkëpunimin e ngushtë me ekspertë juridikë vendorë dhe ndërkombëtarë, zyrtarë qeveritarë dhe organizata profesionale. Objektivi ka qenë përafrimi i kornizës ligjore ekzistuese me standardet ndërkombëtare, duke reflektuar gjithashtu nevojat dhe aspiratat e OMK-së për t'u zhvilluar në një organizatë profesionale të nivelit evropian e botëror. Ndihma e ofruar ka lehtësuar krijimin e partneriteteve bashkëpunuese me institucione të ngjashme në rajon dhe në vendet evropiane. Kjo ka mbështetur rritjen e kuadrit ligjor për OMK-në, ka përmirësuar performancën e strukturave qeverisëse dhe ka nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të OPSh-ve, veçanërisht të OMK-së.

Në fillim të themelimit të OMK-së në vitin 2014, përmes "Programit për Mbështetjen e Shëndetësisë në Kosovë KSV/014", dhe më pas në fazën e dytë të këtij projekti, KSV/017 (duke filluar në vitin 2016), është ofruar mbështetje teknike dhe financiare për përshtatjen dhe rivitalizimin e ambienteve të Odave të Professionistëve Shëndetësorë. Ambientet e reja do të përfshijnë zyra si dhe hapësira të dedikuara për konferenca, seminare dhe takime pune për profesionistët e kujdesit shëndetësor. Kjo strukturë e re do të sigurojë mjedise më të përshtatshme për funksionimin, shërbimet dhe aktivitetet e OPSh-ve. Ndërtesa e re do të jetë miqësore me mjedisin dhe do të ndërtohet duke pasur parasysh qëndrueshmërinë afatgjatë.

Me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të përgjithshëm organizativ, produktivitetit, vendim-marrjes dhe efektivitetit, ofrohet asistencë teknike për dixhitalizimin e proceseve të punës, si dhe ngritjen e një sistemi të menaxhimit të informacionit për OMK-në.

Përveç investimeve në legjislacion dhe infrastrukturë, fuqizimi i stafit të OMK-së në planifikimin strategjik, zhvillimin e lidhshmërisë, menaxhimin financiar dhe qeverisjen efektive është, gjithashtu, në fokusin kryesor të partneritetit ndërmjet projektit KSV/017 dhe OMK-së. Nëpërmjet organizimit të vizitave studimore, takimeve të punës dhe konferencave të ndryshme shkencore, projekti ka lehtësuar mundësitë për pjesëmarrjen e stafit të OMK-së, mjekëve dhe profesionistëve të tjerë të kujdesit shëndetësor në ngjarje të ndryshme profesionale. Kjo e ka mbështetur OMK-në në zhvillimin e bashkëpunimit me organizata të ngjashme në rajon dhe në Bashkimin Evropian për shkëmbimin e praktikave dhe përvojave si dhe sigurimin e njohjes dhe anëtarësimit të OMK-së në rrjetin profesional përkatës, anëtarësimin dhe iniciativat në BE dhe në botë.

Gjatë dekadës së kaluar, Oda e Mjekëve të Kosovës ka demonstruar përkushtim të palëkundur për të evoluar në një organizatë profesionale të qëndrueshme dhe të suksesshme, të cilën ne jemi krenarë ta mbështesim.



Takimi me përfaqësues të LuxDev, projekti KSV-017

OMK NDËR VITE



Amela Kolenovic

Eksperte e jashtme,
Oda e Mjekëve të Kosovës-
LuxDev KSV 017

Ideja për themelimin e Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK) ka ardhur si një përgjigje ndaj nevojës për të zbatuar konceptin 100-vjeçar të vetë-administrimit të profesionit të mjekut, i cili ka nisur të aplikohet që nga fillimi i shekullit të kaluar.

Ky koncept vazhdoi të zhvillohet në shtetet demokratike, ndërsa në bllokun komunist u shua pasi kundërshtonte konceptin qendror dhe idenë e kontrollit të çdo gjëje nga shteti dhe partia.

Në kuadër të procesit të reformave, Ministria e Shëndetësisë është angazhuar për ta konkretizuar këtë koncept dhe, përmes organizimit të punëtorive dhe diskutimeve intensive, janë diskutuar dhe analizuar modalitetet e mundshme për themelimin e Odave të Profesionistëve Shëndetësorë. Ndër ekspertët dhe përfaqësuesit e përfshirë në këto procese, veçanërisht duhet përmendur Dr. Ramin Parsa Parsi, Dr. Salih Berisha dhe z. Domen Podnar nga Asociacioni i Mjekëve të Gjermanisë, të cilët dhanë kontribut të rëndësishëm dhe mbështetje të thellë për procesin e krijimit të kësaj strukture si pjesë e konceptit modern të vetë-qeverisjes së profesionistëve shëndetësorë.

Si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme dhe dialogut të zhvilluar, Ligji për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë Nr. 04/L-150, u miratua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 30 maj 2013.

Ligji për Odat dhe inaugurimi i OMK-së

Miratimi i ligjit për OPSH-të ishte një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të një institucioni të specializuar dhe profesional që ka për qëllim të përfaqësojë, mbrojë dhe zhvillojë interesat dhe përgjegjësitë e mjekëve të Kosovës. Në një sektor të ndjeshëm si ai shëndetësor, që ka ndikim kryesor në mirëqenien e qytetarëve, është thelbësore të ketë një zë të bashkuar që i përfaqëson dhe mbron sa më mirë profesionin dhe profesionistët e kësaj fushe.

Në nëntor 2013, u bë inaugurimi i Odës së Mjekëve të Kosovës, një ngjarje e rëndësishme që u shoqërua me zgjedhjen e Kryetares së OMK-së, Prof.Dr. Zylfije Hundozi. Ceremonia e inaugurimit ishte një ngjarje solemne, ku morën pjesë përfaqësues nga Odat e Mjekëve nga Gjermania, Austria, Hungaria, Kroacia, Mali i Zi, Bosnjë e Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, si dhe përfaqësues të lartë të misioneve diplomatike në Kosovë.

Përpjekja për funksionalizimin e Odës së Mjekëve përballoi sfida të mëdha me të cilat u ballafaquan udhëheqësit e mandatit të parë. Ligji që rregullonte Odat e Profesionistëve Shëndetësorë parashikonte transferimin e kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) tek Odat e Profesionistëve Shëndetësorë gjatë tre viteve të para të krijimit të tyre. Megjithatë, përballja me pengesat politiko-administrative ishte e pavitueshme dhe, gjatë mandatit të parë, Oda e Mjekëve nuk arriti të ndërmarrë me sukses misionin kryesor për të krijuar një institucion të pavarur që përfaqësonte me dinjitet profesionin mjekësor në Kosovë.

Përballë sfidave, gjatë mandatit të parë, Oda e Mjekëve të Kosovës ka ndërmarrë hapa thelbësorë për të përmirësuar organizimin e veprimtarisë së saj. Ky proces ka përfshirë miratimin e Statutit të Odës dhe zbatimin e disa rregulloreve kyçe. Për më tepër, OMK ka arritur të ndërtojë një prezencë të konsiderueshme në skenën ndërkombëtare, duke marrë pjesë në ngjarje të shumta të rëndësishme.

Megjithatë, për shkak të dështimit të fillimit të procesit të anëtarësimit të mjekëve dhe, po ashtu, për shkak të mungesës së kompetencave kyçe të garantuara me ligj për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, gjatë kohës së mandatit të parë Oda e Mjekëve të Kosovës nuk ka arritur të sigurojë pavarësinë dhe stabilitetin funksional dhe financiar.

Krijimi i organeve dhe fuqizimi i Odës



Bartja e kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë në Odën e Mjekëve të Kosovës

Pas një procesi zgjedhor të suksesshëm në dhjetor të vitit 2017, në Kuvendin e parë të mandatit të dytë të Odës së Mjekëve të Kosovës, u zhvilluan zgjedhjet për kryetar-in e ri të OMK-së. Kandidati i suksesshëm ishte Dr. Pleurat Sejdiu, dhe me ardhjen e strukturave të reja në Odën e Mjekëve të Kosovës, nisi një periudhë e re për zhvillimin e OMK-së.

Gjatë mandatit të parë të Odës së Mjekëve të Kosovës, të gjitha aktivitetet e zhvilluara u mundësuan me përkrahjen financiare të Projektit KSV/017 nga Lux-Dev. Ky projekt ofroi mbështetje të rëndësishme dhe të vazhdueshme financiare për të mundësuar zhvillimin e veprimtarisë të organizatës. Kjo mbështetje është vazhduar gjatë mandatit të dytë dhe po vazhdon ende, por këtë herë për të realizuar disa aktivitete strategjike të rëndësishme, të cilat do të përmenden më të detajuara në vijim.

Në vitin 2018, Odës së Mjekëve iu dha forma e saj origjinale, një periudhë e rëndësishme ku u krijuan organet themelore të Odës dhe u nis procesi i anëtarësimit të mjekëve. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe u realizua edhe bartja e kompetencave të Mbikëqyrjes Etiko Profesionale, Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, si dhe Licencimit dhe Ri-Licencimit të mjekëve nga Ministria e Shëndetësisë të Oda e Mjekëve. Në këtë drejtim, OMK ka filluar të shqyrtojë rastet e para të mbikëqyrjes Etiko-Profesionale, ka përkrahur financiarisht organizimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm profesional, ka filluar procesin e licencimit dhe ri-licencimit të mjekëve anëtarë të OMK-së. Në të njëjtin vit, OMK ka nisur edhe procesin e pajisjes së anëtarëve me faksimile unike për të gjithë anëtarët e licencuar, proces që u mor si shembull edhe nga organizatat simotra në disa shtete.

Gjatë këtij viti, Oda e Mjekëve të Kosovës ka arritur të fitojë mandatin e mbikëqyrës në Organizatën Qendrore të Mjekëve Evropianë (CPME). Po ashtu, kryetari i OMK-së, Dr. Pleurat Sejdiu ka arritur të sigurojë një hapësirë brenda kompleksit të QKUK-së për zyrat e Odës, të cilat u rinovuan përmes përkrahjes financiare nga Lux-Dev.

Në të njëjtën kohë, shërbimi profesional i OMK-së është zhvilluar dhe ka arritur

strukturën e nevojshme për të mbështetur zbatimin e të gjitha aktiviteteve të parapara me ligj.

Në vitin 2018, duke marrë parasysh veprimtaritë e lartpërmendura, Oda e Mjekëve të Kosovës ka arritur të ndërtojë pavarësi dhe stabilitet financiar, duke i lejuar kështu që të prezantojë me sukses një projekt buxheti për vitin 2019 në seancën e radhës të Kuvendit, përfshirë të gjitha veprimtaritë e parashikuara për vitin në vazhdim.

Në vitin 2019, pas vitit stabilizues dhe organizativ, OMK shënoi fillimi hapave konkretë në sferën e aktiviteteve profesionale, si organizimin e Kongreseve vjetore ku morën pjesë përafërsisht 2000 mjekë të fushave të ndryshme. Me këtë filozofi gjithëpërfshirëse dhe qasje shumë-disiplinore vazhduan Kongreset vjetore me tema bosht të parapara në baza vjetore. Në këto kongrese mjekët patën rastin të ndjekin punimet shkencore nga ligjërues vendorë dhe të huaj. Përveç ligjëratave, gjatë kongresit gjithashtu, paralelisht, u zhvilluan edhe punëtori nga ekspertë të fushave përkatëse me tema të ndryshme.

Në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional, OMK financoi dhe bashkë-organizoi mbi 60 kongrese, konferenca, punëtori, tryeza e tubime të ndryshme profesionale.

Po ashtu, gjatë vitit 2019 me iniciativë të kryetarit të OMK-së, Dr. Pleurat Sejdiu, filluan bisedimet e para për ndërtimin e një objekti të përbashkët për të gjitha Odat e Profesionistëve Shëndetësorë (OPSH), i cili do të financohej nga Projekti KSV/017 i Lux-Dev, "Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë". Pas sfidave të shumta, ky projekt arriti të fillojë të realizohet vetëm në fillim të vitit 2023, falë angazhimit të Kryetarit të Prishtinës, z. Përparim Rama, si dhe përkrahjes nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, ku gjatë seancës së mbajtur në dhjetor të 2022 u vo-

tua për dhënien në shfrytëzim të parcelës për ndërtimin e një objekti të përbashkët për të gjitha Odat e Profesionistëve Shëndetësorë. Ky projekt do të realizohet me përkrahjen financiare nga Qeveria e Dukatit të Luksemburgut përmes Agjencisë për zhvillim LuxDev.

Revista Mjeku

Viti 2020 solli sfida të veçanta për shkak të pandemisë COVID-19. Qeveria e Kosovës shpalli gjendjen e emergjencës për shëndetin publik dhe mori masa për parandalimin e përhapjes së virusit. Si pasojë e kësaj, OMK-ja u detyrua të pezullojë disa iniciativa/projekte dhe vazhdoi punën në zyrat e saj duke respektuar masat anti COVID-19.

Me datën 30 mars 2021, në ditën ndërkombëtare të mjekëve, OMK bëri botimin e Revistës Mjeku. Kjo revistë botohet për herë të parë në Kosovë, dhe trajton aktualitete të ndryshme nga mjekësia kosovare dhe më gjerë. Revista Mjeku vjen si rezultat i vizionit dhe angazhimit të Odës së Mjekëve të Kosovës për një revistë informative që i dedikohet mjekut kosovar dhe lexuesve të tjerë potencialë të interesuar në aktualitetet e shëndetësisë kosovare. Këshilli Redaktues është i përbërë nga anëtarë të cilët i bashkon bagazhi i madh profesional dhe akademik, por edhe sensi i detyrimit për ta bërë gjithnjë një "hap tutje" në shëndetësinë kosovare.

Pas një partneriteti të suksesshëm, në muajin dhjetor 2021, Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projekti i LuxDev nënshkruan Marrëveshje për Delegimin e fondeve dhe implementimin e aktiviteteve lidhur me ndërtimin e kapaciteteve të stafit mjekësor të Spitaleve të Përgjithshme në Gjilan dhe Prizren. Ky program është hartuar në përputhje me planin e menaxhimit të burimeve njerëzore të dy spitaleve për periudhën 2022-2026. Përmes trajnimeve të ofruara,

mjekët e këtyre dy spitaleve do të kenë mundësinë të avancojnë shkathtësitë dhe njohuritë e tyre në aspektin profesional. Kjo nismë do të ndihmojë në rritjen e cilësisë së kujdesit shëndetësor dhe përparimin e sektorit mjekësor në tërësi.

Viti 2021 u dallua me organizimin e Zgjedhjeve për mandatin e tretë të Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK). Si rezultatet i këtyre zgjedhjeve, Dr. Pleurat Sejdiu u rizgjodh për një mandat të dytë në krye të OMK-së,



Nënshkrimi i marrëveshjes për parcelën e OPSH-ve

duke vazhduar punën ekipore si 4 vitet paraprake.

Obelisku dhe Dita e Përkujtimit të profesionistëve

2022

Me datë 16 shkurt, në hyrjen e QKUK-së, u bë inaugurimi i monumentit përkujtimor Obeliskut të dedikuar të gjithë profesionistëve shëndetësorë. Ky projekt u realizua me iniciativën e kryetarit të OMK-së, Dr. Pleurat Sejdiu, dhe në bashkëpunim me të gjitha Odat e Profesionistëve Shëndetësorë të Kosovës. Gjithashtu, 16 shkurti u shpall nga Odat e Profesionistëve Shëndetësorë si "Ditë Përkujtimore e profesionistëve shëndetësorë të Republikës së Kosovës".

Nisja e implementimit të Sistemit Informativ dhe baza interaktive e të dhënave, e cila do të integrojë të gjitha proceset e Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK), është një hap i rëndësishëm që ka marrë mbështetjen e projektit të LuxDev. Ky sistem pritet të hyjë

në funksion në shtator të vitit 2023 dhe synon të sjellë një transformim në mënyrën se si OMK menaxhon dhe monitoron të dhënat, duke i bërë ato më të qasshme dhe të përditësuar. Kjo ndërhyrje inovative do të mundësojë një koordinim më të mirë të aktiviteteve, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e efikasitetit të punës. Kjo është një ndër nismat kyçe që do të ndihmojë OMK-në të bëhet më produktive dhe të ofrojë një shërbim më të mirë për anëtarët e saj dhe për komunitetin mjekësor në përgjithësi.

Oda Sot

Aktualisht, Oda e Mjekëve ka një numër prej 5784 anëtarësh aktivë, të cilët ndërveprojnë rregullisht me Odën e Mjekëve lidhur me shërbimet e ndryshme.

Ndërsa ndërtimi i objektit të ri dhe implementimi i sistemit të ri digjital janë në pritje, OMK-ja vazhdon të bëjë përparim dhe t'u përgjigjet sfidave të reja. Në këtë peri-

udhë të veçantë, OMK-ja është krenare për arritjet e saj dhe me datën 18 shtator do të festojë 10-vjetorin e saj me një ngjarje festive në prani të miqve ndërkombëtarë dhe akterëve lokalë.



Obelisku në nderim të profesionistëve shëndetësor që kanë humbur jetën gjatë ushtrimit të detyrës në etapa të ndryshme

REVISTA MJEKU



Fisnik Kurshumliu

Kryeredaktor i Revista Mjeku

Revista Mjeku është revistë e Odës së Mjekëve të Kosovës, e cila është themeluar në janar të vitit 2021. Kjo revistë publikohet katër herë në vit dhe trajton tematika të ndryshme nga shëndetësia. Numrat e revistës organizohen në tema bosht, të cilat përcaktohen nga redaksia.

Në kohën e zhvillimeve të shumta të botës mjekësore, përditësimi me të dhënat e fundit dhe trendet aktuale është me rëndësi kyçe për mjekët.

Revista Mjeku shërben si burim i dobishëm që ofron të dhëna të përditësuara për profesionistët në mënyrë që ata të jenë në krye të detyrës. Në vijim do t'i përmend disa nga elementet e Revistës Mjeku që i konsideroj të rëndësishme:

1. Platformë për shkëmbim të dijes: Revista Mjeku shërben si platformë për shkëmbim të dijes, duke ua ofruar mundësinë mjekëve që ta ndajnë përvojën dhe njohuritë e tyre me kolegët. Gjithashtu, e stimulon bashkëpunimin dhe e inkurajon shpërndarjen e informatave të vlefshme duke e ngritur kështu standardin e kujdesit ndaj pacientit.

2. Përditësimi me të reja nga mjekësia: Fusha e mjekësisë është në evolucion konstant. Si profesionistë shëndetësorë vazhdimisht jemi të "bombarduar" me trajtime dhe teknologji të reja si dhe të dhëna nga hulumtimet e reja shkencore. Revista Mjeku duhet të shërbejë si burim i besueshëm i informacionit, duke bërë kështu përditësimin e mjekëve me njohuritë dhe informacionet më të reja mbi hulumtimet klinike dhe praktikatat më të mira bazuar në dëshmitë shkencore.

3. Edukimi i vazhdueshëm profesional: Revista Mjeku ofron mundësi për edukim të vazhdueshëm profesional (EVP). Përmes shkrimeve në numrat përkatës të RM-së autorët fitojnë EVP kredi. Gjithashtu, në të ardhmen e afërt, parashihet që kontributi në cilësinë e vlerësuesit (reviewer) gjithashtu të rezultojë me fitim të

kredive të EVP-së. Opsione të tjera përmes kuizeve (online) etj., parashihen gjithashtu, si forma shtesë të përfitimit të kredive të EVP-së.

4. Praktikatat më të mira në mjekësi: Revista Mjeku shpesh publikon artikuj nga ekspertët e fushave të ndryshme të mjekësisë. Këta artikuj ofrojnë të dhëna në lidhje me praktikatat më të mira, udhëzuesit dhe protokollet terapeutike më të reja. Duke i përcjellë këto rekomandime, mjekët i përmirësojnë rezultatet e punës së tyre te pacientët.

5. Adresimi i çështjeve etike dhe ligjore: Revista Mjeku ofron artikuj nga etika mjekësore dhe legjislativi. Kjo i ndihmon profesionistët shëndetësorë që të bëjnë vendime të duhura bazuar në informatat përkatëse të sigurta nga këto aspekte. Në këtë mënyrë ata e ruajnë integritetin e tyre personal, profesional dhe janë në pozitë për t'i realizuar standardet më të larta etike gjatë ushtrimit të profesionit.

6. Rrjetëzimi (networking): Revista Mjeku ofron informata për konferencat, punëtoritë dhe ngjarje të tjera profesionale. Përmes pjesëmarrjes në këto ngjarje mjekët përveç se fitojnë kredi të EVP-së krijojnë rrjete profesionale me kolegët e tyre, mësojnë nga ekspertët dhe e përmirësojnë zhvillimin e tyre profesional. Revista Mjeku është një burim i dobishëm i informatave në lidhje me këto evenimente.

Konkluzion: Revista Mjeku duhet të luajë rol të rëndësishëm në jetën profesionale të profesionistëve shëndetësorë. Ajo shërben si burim i informatave të rëndësishme, lehtëson shkëmbimin e njohurive, bën përditësimin e profesionistëve shëndetësorë, ofron edukim të vazhdueshëm profesional, ofron të dhëna në lidhje me praktikatat më të mira, adreson sfidat e mjekësisë dhe shëndetësisë, si dhe stimulon rrjetëzimin. Duke i përdorur resurset e ofruara nga Revista Mjeku, profesionistët shëndetësorë i zhvillojnë shkathtësitë e tyre, përmirësojnë kujdesin ndaj pacientit dhe qëndrojnë në krye të detyrës profesionale.



Numrat e Revista Mjeku

Korrespondenca:
fisnik.kurshumliu@uni-pr.edu

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS - DEKORATAT



Oda e Mjekëve të Kosovës

Oda e Mjekëve të Kosovës bënë ndarjen e 4 lloje të dekoratave:

1. DEKORATA NDERI I MJEKUT "ALI SOKOLI"
2. DEKORATA PËR ARRITJE SHKENCORE "MUSA HAXHIU"
3. MIRËNJOHJA E ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS
4. MEDALJA PËRKUJTIMORE EODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS

1. DEKORATA NDERI I MJEKUT "ALI SOKOLI"

Dekorata e Nderit, si vlerësimi më i lartë i Odës, u jepet anëtarëve të Odës për arritje të jashtëzakonshme gjatë ushtrimit të profesionit të mjekut në situata të krizës sociale ose në rrethana të tjera të jashtëzakonshme ose të rrezikshme për jetën, si dhe për arritje të jashtëzakonshme profesionale që kanë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme nivelin ekzistues të ofrimit të kujdesit shëndetësor, veprimtarinë në kujdesin shëndetësor dhe sistemin e kujdesit shëndetësor në tërësi

2. DEKORATA PËR ARRITJE SHKENCORE "MUSA HAXHIU"

Dekorata për arritje shkencore e Odës së Mjekëve të Kosovës u jepet anëtarëve të Odës të cilët kanë të arritura të vërtetuara në fushën e mjeksisë, me kontributin e shprehur në nivel evropian dhe botëror.

3. MIRËNJOHJA E ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS

Mirënjohja e Odës së Mjekëve të Kosovës u jepet anëtarëve të Odës dhe individëve të tjerë, pas daljes në pension, institucioneve, organizatave, shoqatave dhe personave juridikë për dhënien e kontributit të çmueshëm në punën dhe organizimin e Odës dhe për dhënien e kontributit në promovimin e vlerave të Odës e për ndihmën në realizimin e detyrave, programeve, projekteve dhe qëllimeve thelbësore të Odës në Republikën e Kosovës dhe jashtë vendit.

4. MEDALJA PËRKUJTIMORE E ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS

Medalja përkujtimore e Odës së Mjekëve të Kosovës i jepet një anëtar të Odës pas vdekjes si shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi për anëtarësi të përgjegjshme shumëvjeçare dhe kontribut në punën e Odës së Mjekëve të Kosovës si dhe në dhënjen e shërbimeve shëndetësore popullatës së Kosovës.

Dekorata Nderi i Mjekut "ALI SOKOLI"
Abdylatif Fusha*
Adem Ademi*
Adnan Shabani
Agim Serhati*
Agron Pustina
Ali Sokoli*
Ali Zatriqi*
Asllan Elezi*
Bajram Koca
Bajram Rexhepi*
Bedri Bakalli*
Besim Sllamniku
Bexhet Canhasi
Binak Kastrati
Bylbyl Shehu*
Daut Mustafa*
Durmish Celina*
Emine Gashi
Emine Halimi*
Enver Baraku
Enver Haxhiu
Eshref Biçaku*
Fahredin Hoti*
Fahri Rashiti
Faik Hima
Fatmir Krasniqi*
Fehmi Henci*
Gani Demolli*
Gazmend Shaqiri*
Gjok Prenaj
Hafir Shala*
Hajredin Ukelli*
Hamdi Çela*
Hasan Jakupi
Hashim Maloku*
Hazir Malaj
Hysen Ukmata*
Hyzri Tafarshiku*
Igballe Oshlani*
Igballe Piperku
Ilhami Goranci*
Imer Mustafa*
Irfan Spahiu
Isa Kaliqani*
Ismajl Aliu

Korrespondenca:
revistamjeku@omk-rks.org

Ismet Abdullahu Ferizaj*
Isuf Dedushaj
Izedin Osmani*
Izet Hima*
Jusuf Rexhepi*
Jusuf Telaku
Kajmak Gazideda*
Lec – Gradica*
Mahir Morina
Mazllum Belegu
Mehmet Begraca*
Meshqyre Çapuni Brestovci*
Mihrije Rukiqi*
Muhamet Guguli*
Muharem Kutllovci*
Muharrem Gashi *
Muhedin Salihamixhiq*
Mustafë Ademaj*
Naser Ahmeti*
Nazim Ymeri*
Nexhdet Kryeziu*
Nuredin Zejnullahu*
Nysret Ramadani
Nysret Ramadani
Njazi Badivuku*
Njazi Suhodolli
Orhan Kubati
Pavli Floko
Palush Prenaj*
Qamil Haxhiu*
Refik Ramku
Remzi Izairi*
Rexhep Hajdaraj*
Rifat Lila
Riza Binishi*
Sadri Bajraktari
Samedin Haxhijaha*
Sami Haxhibeqiri*
Sami Spahiu*
Samile Juniku
Sehadete Doko-Mekuli*
Sejdullah Hoxha
Selim Krasniqi*
Simë Dobreci
Skender Gubetini
Skender M. Boshnjaku*

Sylejman Arapi*
Shaban Geci*
Shaban Hasi
Shefki Goxhufi*
Shefqet Berisha
Shefqet Meha *
Shemsedin Popaj
Shpetim Robaj*
Talat Pallaska
Vesel Elezi*
Vezir Bajrami*
Xheladin Deda*
Xhemajl Bajraktari*
Xhemil Bytyqi
Xhevat Gashi*
Ymer Aliu*
Ymer Koqinaj*
Zef Gjoni*
Zeke Zeka
Zenel Kelmendi
Zylfi Azizi
Afrim Tasholli*
Ali Tolaj*
Burim Krasniqi*
Fadil Zuka*
Feti Hetemi*
Gëzim Berisha*
Kujtim Zarari*
Lulzim Kolgjeraj*
Minafir Beshiri*
Muhamet Avdyli*
Negjip Berisha*
Nijazi Ahmeti*
Safet Idrizi*
Sebajdin Smani*
Sedat Hoti*
Sylejman Rexhepi*
Zenel Kabashi*
Sulejman Dulla*
Muharrem Asllani*
Sevdije Korça*
Salih Ahmeti
Drita Mekuli
Nijazi Gashi
Spiro Lito
Vjosa Mulliqi -Kotorri

Medalja Përkujtimore e Odës së Mjekëve të Kosovës
Abaz Krasniqi*
Adem Limani*
Bedri Sadriu*
Bedri Zahiti*
Elmir Tarani*
Ferat Emini*
Gjon Gjioda*
Ilirjane Raça- Bunjaku*
Isak Maxhuni*
Iskender Çitaku*
Nevzat Bajrami*
Nusret Zijabeg*
Orhan Gafuri*
Sami Gjoka*
Sanije Shala- Demiri*
Shaban Jashari*
Lumnije Shala*
Eliza Saliu- Ferati*
Ismet Miftari*
Bedri Bimbashi*
Mevlyde Iljazji*
Nisret Hajrullahu*
Ilir Ilazi*
Hajrullah Saraçi*
Sejdullah Hoxha*
Hakif Sadiku*
Muharrem Krasniqi*
Shevqet Mehmet*
Sebahat Zeqiri*
Mentor Salih*
Ali Iljazji*
Naser Lleshi*
Azijada Jamini*
Ylber Murati*
Nesim Miftari*
Visar Huruglica*

*Post-mortem

Dekorata për Arritje Shkencore "Musa Haxhiu"
Prof. Dr. Musa Haxhiu*
Prof. Dr. Osman Imami*
Prof. Dr. Flamur Blakaj
Prof. Dr. Mentrol Petrela



Dekorata e Nderit, për arritje të jashtëzakonshme gjatë ushtrimit të profesionit të mjekut në situata të krizës sociale ose në rrethana të tjera të jashtëzakonshme ose të rrezikshme për jetën, si dhe për arritje të jashtëzakonshme profesionale që kanë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme nivelin ekzistues të ofrimit të kujdesit shëndetësor, veprimtarinë në kujdesin shëndetësor dhe sistemin e kujdesit shëndetësor në tërësi. I dhurohet Prof. Dr. Salih Ahmeti nga kryetari i Odës së Mjekëve, Dr. Pleurat Sejdiu.



Dekorata e Nderit, për arritje të jashtëzakonshme gjatë ushtrimit të profesionit të mjekut në situata të krizës sociale ose në rrethana të tjera të jashtëzakonshme ose të rrezikshme për jetën, si dhe për arritje të jashtëzakonshme profesionale që kanë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme nivelin ekzistues të ofrimit të kujdesit shëndetësor, veprimtarinë në kujdesin shëndetësor dhe sistemin e kujdesit shëndetësor në tërësi. I dhurohet Prof. Dr. Isuf Dedushaj nga kryetari i Odës së Mjekëve, Dr. Pleurat Sejdiu.



Mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme dhe ngritjen e kapaciteteve të Oda e Mjekësisë së Kosovës në nivel ndërkombëtar. I dhurohet kryetarit të Odës së Mjekëve të Kroacisë, Dr. Ivan Raguz nga kryetari i Odës së Mjekëve, Dr. Pleurat Sejdiu.

KONFERENCAT E ORGANIZUARA NGA OMK



Oda e Mjekëve të Kosovës

Oda e Mjekëve në bazë të Rregullores për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, përmes Kongreseve të organizuara ka për qëllim që anëtarëve të saj në fusha të caktuara t'u ofrojë mundësinë që të fitojnë përvoja nga ekspertët e jashtëm me qëllim të ngritjes së kapaciteteve mjekësore për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Kosovës.

Pjesëmarrja në Kongreset e organizuara nga OMK dhe bashkë-organizimet me institucione të tjera, për të gjithë anëtarët e Odës së Mjekëve të Kosovës është pa pagesë.

Kongresi dhe Panairi i Parë Mjekësor:

Me datë 17 tetor 2019 u bë hapja solemne e Kongresit dhe Panairit të Parë Mjekësor, ku të pranishëm ishin mysafirë të ftuar, ish ministra të shëndetësisë, ligjërues ndërkombëtarë si dhe Sekretarja e Përgjithshme e CPME, znj. Annabel Seeböhm, e cila u drejtua të pranishmëve me një fjalë rasti.

Ndër aktivitetet kryesore ishte edhe promovimi i librit të Prof. Dr. Isuf Dedushaj me titull "Enciklopedi e doktorëve të shkencave të mjekësisë shqiptare gjithandej globit (1445 – 2018) dhe mjekëve që lanë gjurmë të pashlyera në historinë e mjekësisë shqiptare". Po ashtu u ndanë edhe dekorata për profesionistët më të dalluar të fushës së mjekësisë, të cilët pranuan dekoratën Nderi i mjekut "Ali Sokoli" dhe "Musa Haxhiu", për kontributin e veçantë të dhënë në themelimin dhe zhvillimin e shërbimeve dhe institucioneve shëndetësore në Kosovë.

Me qëllim të promovimit të shkencës dhe përkrahjes së zhvillimit të kapaciteteve njerëzore shkencore të vendit, u shpërblyen pesë punimet shkencore më të mira të publikuara përgjatë vitit 2018.

Përveç ligjëratave, gjatë kongresit gjithashtu paralelisht u zhvilluan katër punëtori nga ekspertët të fushave përkatëse me temat: Menaxhimi i avancuar i rrugëve ajrore/Menaxhimi i rrugëve ajrore në Trauma; Diagnostika e avancuar në pacemaker dhe ICD; Këshillimi virtual për kontrceptiv Uveitet, ku pjesëmarrësit u njoftuan me metodat dhe teknologjitë më të reja mjekësore.

Në Kongresin dhe Panairin e Parë Mjekësor morën pjesë mbi 2800 mjekë specialist të fushave të ndryshme, dhe në këtë event mjekë dhe qytetarë kanë mundur t'i përcjellin ligjëratat në ueb faqe të Odës, në kanalën e YouTube të Qendrës së Telemjekësisë, si dhe në të gjitha spitalet rajonale të Kosovës. Përgjatë programit edukativ u zhvillua me shumë sukses edhe Panairi i Mjekësisë, ku kompanive dhe organizatave të ndryshme iu dha mundësia të ekspozojnë produktet, shërbimet dhe aktivitetet e tyre për të interesuarit në Kongres.

Kongresi vjetor për vitin 2020 është shtyrë për një vit më vonë, për shkak të situatës së pandemisë dhe rrethanave të lidhura.

Kongresi i Dytë i Mjekësisë – Onkologji:

Kongresi i Dytë i Mjekësisë-Onkologji, u mbajt me datë 14 tetor 2021, ku në hapjen solemne ishin të pranishëm mysafirë të ftuar, përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, përfaqësues nga komisioni parlamentar për shëndetësi, ligjërues ndërkombëtar etj.

Ndër aktivitetet kryesore ishte edhe promovimi i dy numrave të botuar deri më tani të Revistës Mjeku. Gjatë kësaj mbrëmje u ndanë Dekorata dhe Mirënjohje për nder të mjekëve që kanë ndërruar jetë gjatë vitit 2021, profesionistët më të dalluar të fushës së mjekësisë pranuan dekoratën Nderi i mjekut "Ali Sokoli" dhe "Musa Haxhiu", për kontributin e veçantë të dhënë në themelimin dhe zhvillimin e shërbimeve dhe institucioneve shëndetësore në Kosovë.

Pasi që gjendja me pandeminë gjatë muajit shtator është përmirësuar, këshilli organizativ i ka bërë kërkesë Qendrës operative emergjente të Kosovës për lejimin e mbajtjes së kongresit për numër të caktuar të pjesëmarrësve (deri në 300 persona) dhe si rrjedhojë e kësaj, në mënyrë virtuale dhe me prezencë fizike morën pjesë mbi 2500 pjesëmarrës, duke respektuar masat anti Covid.

Mbi 58 ligjëratat dhe punime u prezantuan në Kongresin e Dytë të Mjekësisë dhe u ndanë në 8 sesione: Pulmologji, Trakti gastrointestinal, Trakti urogjenital, Kokë dhe qafë, Gjinekologji, Gjiri, Onkologji pediatrike, Hematoonkologia.

Kongresi i III-të i Mjekësisë- Pandemia Covid-19, Sfidat dhe Përvojat

Më 18-19 qershor të vitit 2022, Oda e Mjekëve të Kosovës organizoi Kongresin e III-të të Mjekësisë me temën Pandemia Covid-19, Sfidat dhe Përvojat, ku në hapjen solemne morën pjesë përfaqësues të ndryshëm të institucioneve shëndetësore, mjekë ndërkombëtarë si dhe mjekë vendorë të fushave përkatëse. Në ceremoninë e hapjes solemne të Kongresit të III-të të Mjekësisë u nda edhe dekorata nderi i mjekut "Ali Sokoli" për Prof. Dr. Salih Ahmeti, si dhe u ndanë çmimet për 10 punimet më të mira shkencore për vitin 2021. Punimet e Kongresit zgjatën për dy ditë dhe u zhvilluan sipas sesioneve me temat Shëndeti Publik dhe Menaxhimi i Pandemisë Covid-19 dhe Shëndeti Mendor dhe Covid-19.

Në kuadër të këtij Kongresi u mbajtën tre punëtori me temat: Përgjigjet e komunitetit për ndotjen e ajrit, pasqyrë e njohurive të sjelljes dhe kulturore, si dhe reanimimi kardiopulmonar (RKP) dhe menaxhimi i rrugëve të frymëmarrjes të Covid-19.

Pjesë e këtij kongresi ishte gjithashtu edhe panairi mjekësor ku kompani të ndryshme prezantuan produktet dhe shërbimet e tyre në pavionin mjekësor.

Kongresi i IV i Mjekësisë- Diabeti Melit, Qasja interdisciplinare

Kongresi i IV i Mjekësisë trajtoi temën Diabeti Melit, Qasja Ndërdisciplinore, dhe u mbajt më 17-18 nëntor 2022.

Në hapjen solemne të këtij Kongresi të pranishëm ishin Dr. Jusuf Ulaj, Këshilltar për Shëndetësi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Eric Dietz, Ambasador i Luksemburgut, z. Laurent Torche, Sekretar i parë në Ambasadën Zvicerane, Dr. Ivan Raguž, Përfaqësues nga Oda e Mjekëve të Kroacisë, Dr. Fatmir Brahimaj, Kryetar i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, Dr. Nevzat Elezi, Kryetar i Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë të Maqedonisë si dhe ligjërues të huaj dhe vendorë.

Në këtë ceremoni u ndanë dekorata dhe mirënjohje për përkrahjen e vazhdueshme të Odës së Mjekëve të Kosovës në nivel Ndërkombëtar, mirënjohje për angazhimin dhe promovimin e vlerave, mirënjohje për dhënien e kontributit në promovimin e vlerave të Odës për ndihmën në realizimin e detyrave, programeve, projekteve dhe qëllimeve thelbësore të Odës në Republikën e Kosovës, Mirënjohja/dekorata "ALI SOKOLI", medalje përkujtimore për anëtarët e OMK-së që kanë ndërruar jetë gjatë vitit 2022, mirënjohje për shërbimin ndaj pacientëve dhe punën e vyer në ngritjen profesionale të kuadrove të reja në fushën e Diabetologjisë, Endokrinologjisë dhe Metabolizmit, mirënjohje për kontributin në Endokrinologji dhe Diabetologji në ngritjen e kuadrove, mirënjohje për mjekët e pensionuar gjatë vitit 2022, si dhe mirënjohje për sponsorët.

U trajtuan tema të lëmisë së Diabetit nga përfaqësues të institucioneve relevante, si dhe ligjërues të huaj nga vende të ndryshme,

të cilët shprehën gatishmërinë për të ndarë eksperiencat e tyre me mjekët tanë dhe për të shpalosur të rejtat e fundit të kësaj lëmie. Sesionet e këtij Kongresi ishin: Diabeti tek të rriturit, diabeti tek fëmijët dhe adoleshentët, komplikimet akute të diabetit, komplikimet kronike mikrovaskulare të diabetit, komplikimet kronike makrovaskulare të diabetit.

Ky kongres kishte rreth 2000 pjesëmarrës, mjekë të fushave të ndryshme të mjekësisë dhe 4 punëtori me temat: pompa e insulinës, ketoacidoza diabetike, këmba diabetike, si dhe për herë të parë u mbajt një punëtori me shkollat fillore dhe të mesme me temën diabeti tek fëmijët dhe adoleshentët, trajtimi dhe stigmatizimi, realitet apo trillim?. Gjithashtu u mbajt edhe panairi mjekësor me kompani të ndryshme të fushës së mjekësisë.

Bashkëorganizime:

Ndër vite, Oda e Mjekëve të Kosovës bashkërisht me institucione të ndryshme shëndetësore, ka bashkë-organizuar evente për anëtarët e saj.

Më 19 tetor 2018, nën patronazhin e Odës së Mjekëve të Kosovës dhe në bashkë-organizim me njësitë e Bioetikës të Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, në kuadër të UNESCO-s, është organizuar Konferenca e Tretë Ndërkombëtare e Bioetikës me temën: "Solidariteti dhe bashkëpunimi".

Një bashkë-organizim mes Odës së Mjekëve të Kosovës dhe Shoqatës Kosovare për Menaxhimin e rrugëve të Frymëmarrjes u mbajt me 2 mars 2019. Punëtorja trajtonte temën "Ditët ndërkombëtare të menaxhim-

it të rrugëve të frymëmarrjes". Kjo punëtori u nda në dy sesione në të cilat ligjëruan 8 ekspertë ndërkombëtarë dhe 13 vendorë, kurse në sesionin e dytë profesionistët shëndetësorë janë ndarë në 8 grupe për të qenë pjesë e anës praktike të punëtorisë Menaxhimi i Avancuar i Rrugëve të Frymëmarrjes te Trauma.

Ndërsa në të njëjtin vit, më 19 prill, u mbajt Simpoziumi i parë Mbarëshqiptar i Kirurgjisë Pediatricke, nën patronazhin e Odës së Mjekëve të Kosovës dhe Shoqatës së Gjinologëve dhe Obstetërve të Kosovës. Në këtë kongres u prezantuan tema që kanë të bëjnë me shëndetin e gruas, nënës dhe fëmijës. Kongresi u organizua me prani fizike për numër të caktuar të pjesëmarrësve dhe për pjesën tjetër në mënyrë virtuale. Përgjatë ditëve të kongresit ishin mbi 1500 mjekë me prezencë fizike ose virtuale.

Gjatë vitit 2021 u mbajt edhe Kongresi i V-të i Obstetrikës dhe Gjinologjisë në Kosovë, bashkëpunim mes Odës së Mjekëve të Kosovës dhe Shoqatës së Gjinologëve dhe Obstetërve të Kosovës. Në këtë kongres u prezantuan tema që kanë të bëjnë me shëndetin e gruas, nënës dhe fëmijës. Kongresi u organizua me prani fizike për numër të caktuar të pjesëmarrësve dhe për pjesën tjetër në mënyrë virtuale. Përgjatë ditëve të kongresit ishin mbi 1500 mjekë me prezencë fizike ose virtuale.

Një tjetër event i mbajtur në shtator të vitit 2021 është Kongresi i Parë Klinik, bashkë-organizim mes Odës së Mjekëve të Kosovës dhe Kolegjit të Kirurgëve të Kosovës. Në këtë kongres u prezantuan tema të ndryshme prej të gjitha disiplinave kirurgjike nga mbi 40 ligjërues të huaj dhe 50 ligjërues vendorë. Kongresi u organizua me prani fizike për numër të caktuar të pjesëmarrësve dhe për pjesën tjetër në mënyrë virtuale, ku morën pjesë mbi 600 kirurgë nga të gjitha specialitetet kirurgjike.



Kongresi dhe Panairi i Parë i Mjekësisë



Kongresi i IV i Mjekësisë - Diabeti Melit, Qasja interdisiplinare

SONDAZHI

OMK ME BESUESHMËRI TË LARTË NË MESIN E MJEKËVE

Edea Blyta dhe Gramoz Jakupi

Sondazhi i zhvilluar nga Revista Mjeku me 488 anëtarë të Odës së Mjekëve të Kosovës, tregon se mbi 80% të tyre i vlerësojnë si të dobishme për zhvillimin e tyre profesional aktivitetet e OMK-së, derisa mbi 78% të anketuarve janë shprehur të kënaqur me shërbimet e marra në OMK. Rreth 70% të mjekëve mendojnë se specializimet duhet të organizohen e administrohen nga OMK, derisa për Revistën Mjeku kanë njohuri mbi 95% të mjekëve dhe e lexojnë mbi 80% të tyre.

Aktivitetet e OMK-së dhe dobia e tyre për mjekët

Aktivitetet shkencore të organizuara nga Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK) u kanë shërbyer mjekëve të Kosovës në zhvillimin e tyre profesional, derisa mbi ¾ e tyre, kanë pasur rastin që të jenë pjesë e këtyre aktiviteteve profesionale.

Kështu, tregojnë rezultatet e një sondazhi të hapur të zhvilluar nga Revista Mjeku me 488 anëtarë të Odës së Mjekëve të Kosovës, i realizuar gjatë muajit gusht 2023 në Kosovë.

Nga 488 të anketuar, 83.6% të tyre pohuan se aktivitetet shkencore të organizuara nga OMK për aftësimin profesional ishin të dobishme, ndërsa 75.4% të anketuarve pohu-

an se kanë qenë pjesëmarrës në aktivitetet e organizuara nga OMK.

OMK me organet e veta kanë arritur që me sukses t'u shërbëjnë anëtarëve të saj, duke i ndihmuar në zhvillimin e tyre profesional, përfaqësimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Sondazhi ka vënë në pah faktin se anëtarët e OMK-së kanë vlerësime pozitive për shërbimet administrative që i marrin në organet e Odës, me që 78.3% të anketuarve janë shprehur shumë të kënaqur dhe të kënaqur, ndërkohë që 95.3% të anketuarve kanë shprehur vlerësime pozitive për stafin në zyrat e OMK-së (30.1 e kanë vlerësuar stafin si të shkëlqyeshëm; 31.6% shumë të mirë dhe 33.6% të mirë).

Sa i përket përkrahjes ligjore dhe profesionale nga OMK, 63.9% të anketuarve janë deklaruar se e kanë pasur një përkrahje të tillë.

Sondazhi i realizuar tregon, gjithashtu, se 67.4% të anketuarve janë të informuar rreth aktiviteteve shkencore të organizuara nga OMK

Ri-licencimi dhe shkollimi specialistik

Sa i përket mënyrës së licencimit dhe rilicencimit të mjekëve, 68% të anketuarve janë të kënaqur më mënyrën si është i organizuar tani ky proces, ndërkohë që në perspektivë, 38.9% të anketuarve preferojnë që rilicencimi të bëhet çdo 10 vjet; 18.9 % në çdo 7 vjet, derisa 40.6% preferojnë që rilicencimi të jetë çdo 5 vjet sikurse është edhe tani.

Ndërsa, sa i përket organizimit të shkollimit specialistik, 69.7% të mjekëve të anketuar pohojnë se OMK duhet ta organizoj dhe administroj procesin e shkollimit specialistik.

Revista Mjeku


Revista Mjeku, numri i parë i së cilës doli në mars të vitit 2021, sipas sondazhit është mjaft e njohur në mesin e komunitetit mjekësor për faktin se 95.5% e të anketuarve kanë dëgjuar për revistën, derisa 80.5% të mjekëve të anketuar kanë deklaruar se e lexojnë atë.

Sondazhi është realizuar vetëm me anëtarë të OMK-së, në mënyrë elektronike dhe është përbërë prej trembëdhjetë pyetjeve.

Paraqitja grafike e sondazhit

Statusi juaj profesional?


488 responses



Grafikoni 1. Statusi profesional i të anketuarve


Mosha juaj?

488 responses




Grafikoni 2. Mosha e të anketuarve

Sa janë të dobishme aktivitetet shkencore të organizuara nga OMK për aftësimin tuaj profesional?
488 responses




Grafikoni 3. Rëndësia e aktiviteteve shkencore të organizuara nga OMK për mjekët

A keni marrë pjesë në aktivitetet shkencore të organizuara nga OMK?
488 responses




Grafikoni 4. Pjesëmarrja e mjekëve në aktivitetet e organizuara nga OMK

Sa jeni të kënaqur me shërbimet administrative që i merrni në OMK?
488 responses




Grafikoni 5. Kënaqshmëria me shërbimet administrative në OMK

Si është vlerësimi juaj për stafin në zyrat e OMK-së?
488 responses




Grafikoni 6. Kënaqshmëria me stafin në zyrat e OMK-së

A gjeni përkrahje ligjore dhe profesionale nga OMK?
488 responses




Grafikoni 7. Përkrahja ligjore dhe profesionale e OMK-së për mjekët

A jeni mjaftueshëm të informuar rreth organizimeve shkencore të OMK-së?
488 responses



Grafikoni 8. Informimi i mjekëve rreth organizimeve shkencore të OMK-së


A pajtoheni me mënyrën si organizohet licencimi dhe rilicensimi i mjekëve?
488 responses



Grafikoni 9. Pajtueshmëria me mënyrën e organizimit të licencimit dhe ri-licencimit

Rilicencimi, sipas jush duhet të bëhet në çdo:


488 responses



Grafikoni 10: Preferencat e mjekëve rreth afatit të ri-licencimit në të ardhmen

A mendoni se OMK duhet të organizoj dhe administroj shkollimin specialistik?


488 responses



Grafikoni 11: Qëndrimet e mjekëve rreth organizimit dhe administrimit të shkollimit specialistik

A keni dëgjuar për Revista Mjeku?


488 responses



Grafikoni 12: Njohuritë e mjekëve për Revistën Mjeku

A e lexoni revistën Mjeku?

488 responses



Grafikoni 13: Leximi i Revistës Mjeku nga mjekët

NXITJA E BASHKËPUNIMIT TË SHËNDETSHËM DHE TRANSPARENT NDËRMJET KOMPANIVE FARMACEUTIKE DHE ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS



Sistemi i kujdesit shëndetësor është një ekosistem kompleks ku hisedarë të ndryshëm punojnë së bashku për të siguruar mirëqenien e pacientëve. Midis këtyre hisedarëve, kompanitë farmaceutike dhe Odat e Profesionistëve Shëndetësorë (OPSh) në përgjithësi e sidomos Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK), luajnë rolin kryesorë në avancimin e shkencës mjekësore, ofrimin e zgjidhjeve të kujdesit shëndetësor dhe përmirësimin e rezultateve të pacientëve. Megjithatë, bashkëpunimi mes këtyre subjekteve shpesh është parë me dyshim për konflikt të mundshëm interesi dhe mungesë transparence kundruall domosdosë dhe natyrshmërisë së këtij bashkëpunimi. Pikërisht këtu lind nevoja për krijimin e bazës ligjore dhe etike për nxitjen dhe mbështetjen e një bashkëpunimi të shëndetshëm dhe transparent ndërmjet kompanive farmaceutike dhe OPSh, duke theksuar rëndësinë e një bashkëpunimi të tillë në përpjekjen e vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor.

Roli i kompanive farmaceutike dhe Odës së Mjekëve

Kompanitë farmaceutike janë në krye të inovacionit mjekësor duke investuar në mënyrë të vazhdueshme në kërkime shkencore dhe zhvillim të ilaçeve dhe terapive të reja që mund të lehtësojnë vuajtjet dhe të shpëtojnë jetë. Roli i tyre në kujdesin shëndetësor është i pamohueshëm, pasi sjellin në treg ilaçe dhe vaksina jetike, duke trajtuar sëmundjet që prekin miliona por edhe sëmundjet e rralla që prekin shumë më pak individë me shumë më pak mundësi mjekimi.

Nga ana tjetër, Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale në të cilën anëtarësohen dhe licencohen mjekët që ushtrojnë veprimtari mjekësore në Republikën e Kosovës. OMK shërben si organ profesional që bënë së bashku mjekë, ofruen të kujdesit shëndetësor dhe ekspertë në disiplina të ndryshme mjekësore. Ata krijojnë dhe mbështesin standardet etike brenda komunitetit mjekësor, ofrojnë edukim të vazhdueshëm dhe ofrojnë udhëzime për praktikën më të mira. Dhomat mjekësore janë thelbësore për ruajtjen e integritetit të profesionit të kujdesit shëndetësor dhe për të siguruar që pacientët të marrin kujdesin më cilësor.

Figurativisht, roli i këtyre dy aktorëve të ekosistemit shëndetësor ngjanë me dy lumenj që rrjedhin në drejtim të njëjtë – në interesin më të mirë të mundshëm të shëndetit të pacientit, duke u shkëmbyer përgjatë rrugës disa herë, deri sa të derdhen së bashku në detin e shëndetit të pacientit. Këto pika-shkëmbimi në realitet natyrshëm krijojnë nevoja bashkëpunimi.

Nevoja për Bashkëpunim

Më shumë se kudo tjetër natyrshmëria por edhe domosdoshmëria e bashkëpunimit ndërmjet kompanive farmaceutike dhe OPSh shpërfaqet në nevojën për kërkime shkencore dhe zhvillim të

ilaçeve, produkteve terapeutike dhe pajisjeve diagnostike. Kompanitë farmaceutike mbështeten në ekspertizën e profesionistëve të kujdesit shëndetësor për të kryer prova klinike dhe për të mbledhur njohuri të vlefshme për sigurinë dhe efikasitetin e produkteve të tyre. Oda e Mjekëve mund ta lehtësojë këtë bashkëpunim, duke siguruar që kërkimi të kryhet në mënyrë etike dhe transparente. Deri më sot, një bashkëpunim i tillë mes OMK dhe cilësdo Kompani Farmaceutike, të pranishme në Kosovë nuk është shënuar para së gjithash në mungesë të një baze ligjore që do të rregullonte hulumtimet shkencore klinike. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që nesër ekosistemi shëndetësor kosovar të mos jetë burim i të dhënave shkencore me vlerë globale.

Më tepër se kudo tjetër, nevoja për bashkëpunim mes Kompanive Farmaceutike dhe OMK-së ndjehet në fushën e edukimit dhe trajnimit të vazhdueshëm profesional të mjekëve. OMK ofrojnë një platformë funksionale për kompanitë farmaceutike për të edukuar profesionistët e kujdesit shëndetësor rreth trajtimeve dhe terapive të reja. Ky edukim kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kujdesit ndaj pacientit duke përditësuar mjekët me përparimet më të fundit mjekësore nga dora e parë. Kjo nuk ndodhë vetëm në takimet specifike tematike të organizuara në mënyrë direkte dhe në bashkëpunim të drejtpërdrejtë. Akoma më shumë ky edukim dhe trajnim zhvillohet përmes organizimit të Kongreseve, Simpoziumeve, Seminare, Konferencave dhe ngjarjeve të tjera shkencore ku Kompanitë Farmaceutike prezantojnë zbulimet dhe risitë më të fundit në fushën e trajtimit apo diagnostikimit bashkë me aplikueshmërinë e tyre në punën e përditshme të mjekëve.

Krejt ky bashkëpunim jo rrallë shihet me dyshim, sidomos në sistemet shëndetësore në tranzicion, ku konflikti i interesit mund të vijë në shprehje më lehtë. Prandaj, bashkëpunimi i ngushtë dhe transparent mes OMK-së dhe Kompanive farmaceutike duhet të garantojë dhe garanton mbikëqyrjen etike të proceseve të bashkëpunimit. Bashkëpunimi me OMK mund dhe duhet t'u sigurojë kompanive farmaceutike udhëzime dhe mbikëqyrje etike, duke i ndihmuar ato të shmangin plotësisht konfliktet e mundshme të interesit duke siguruar që aktivitetet e tyre të marketingut dhe promovimit të përputhen me etikën mjekësore.

Mbikëqyrja etike para së gjithash ka në esencë mbrojtjen e pacientit. Si kompanitë farmaceutike ashtu edhe OMK ndajnë një qëllim të përbashkët për përmirësimin e rezultateve të pacientëve. Bashkëpunimi në iniciativa të tilla si fushatat e ndërgjegjësimit për sëmundjet dhe edukimi i pacientëve mund të rrisë kujdesin dhe mbështetjen e pacientit. Këto aktivitete, të organizuara së bashku nga këta dy hisedarë, kanë një ndikim dhe efekt shumë më të madh sesa aktivitetet e njëjta të organizuara në mënyrë të pavarur nga këta dy hisedarë.

Përgjatë kësaj game të gjerë bashkëpunimi, transparenca dhe përgjegjshmëria e secilës palë është e domosdoshme. Një kuadër bashkëpunimi transparent mund të ndihmojë në ndërtimin e besimit midis palëve të interesuara, duke përfshirë pacientët dhe publikun. Ky kuadër siguron që ndërveprimet ndërmjet kompanive farmaceutike dhe OMK-së të jenë të hapura, të përgjegjshme dhe pa ndikime të panevojshme apo konflikte interesi.

Krijimi i një bashkëpunimi të shëndetshëm dhe transparent mes Roche-Kosovë dhe OMK-së

Për nxitjen dhe mbështetjen e një bashkëpunimi të shëndetshëm dhe transparent midis kompanive farmaceutike, në këtë rast Kompanisë Hoffmann-La Roche LTD, Zyrës Përfaqësuese në Kosovë dhe OMK-së, janë respektuar me përpikëri nevojat e përshkruara me sipër duke marrë parasysh udhëzimet e qarta, paraprakisht të dakorduara. Bazuar në rregulloret e brendshme të të dyja palëve, për bashkëpunimin tonë të shëndetshëm shumëvjeçar, ne kemi zhvilluar udhëzime dhe kode të qarta sjelljeje që përshkruajnë pritshmëritë dhe përgjegjësitë e të dyja palëve në bashkëpunim. Këto udhëzime theksojnë transparencën, sjelljen etike dhe interesat më të mira të pacientëve.

Në mënyrë që aktivitetet bashkëpunuese të rishikohen dhe monitorohen në mënyrë të pavarur dhe objektive kemi krijuar Komitete të pavarura mbikëqyrëse, sikur në rastin e zbatimit të Memorandumit të bashkëpunimit të nënshkruar së fundmi. Përmes kësaj mbikëqyrje të pavarur do të sigurohemi që aktivitetet bashkëpunuese të përputhen me standardet etike dhe të mos rrezikojnë kujdesin ndaj pacientit.

Në Kongreset dhe Konferencat e OMK-së kemi bërë përpjekje që në vazhdimësi të ofrojmë programe arsimore dhe mundësi trajnimi për profesionistët e kujdesit shëndetësor për të përmirësuar të kuptuarit e tyre për industrinë farmaceutike, produktet e saj, përfitimet dhe rreziqet e mundshme që lidhen me trajtimet e reja. Falë bashkëpunimit të shëndetshëm dhe transparent, ky edukim dhe trajnim ka prodhuar efekt të drejt-përdrejtë dhe të prekshëm në avancimin e cilësisë së kujdesit për pacientët në Kosovë.

Bashkëpunimi ynë është mbështetur në shkëmbim të vazhdueshëm informacioni. Promovimi i komunikimit të hapur dhe transparent ndërmjet Roche-së dhe OMK-së jo vetëm që ka lehtësuar shkëmbimin e njohurive shkencore dhe mjekësore por edhe ka mundësuar vlerësimin dhe detektimin e nevojave të mjekëve për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Strumbullari i krejt këtyre përpjekjeve dhe këtij bashkëpunimi ka qenë dhe mbetet pacienti dhe nevojat e tij. Prandaj, përfshirja e pacientit, natyrshëm mbetet domosdoshmëri e natyrshme e secilit bashkëpunim. Vështirësitë e zakonshme si ato të identifikimit të pacientit përfaqësues tipik apo grupeve dhe organizatave gjegjëse të pacientëve nuk janë të ndryshme nga ato në vendet tjera. Megjithatë, në këtë përpjekje është vendimtarë ndërgjegjësimi i përbashkët që përfshirja e grupeve të avokimit të pacientëve dhe përfaqësuesve të pacientëve në përpjekjet bashkëpunuese është i domosdoshëm për të siguruar që perspektivat dhe nevojat e pacientit të merren parasysh gjatë gjithë procesit.

Përfundim

Nuk ka dyshim që bashkëpunimi ndërmjet kompanive farmaceutike dhe OMK-së është thelbësor për avancimin e kujdesit shëndetësor, nxitjen e inovacionit mjekësor dhe përmirësimin e rezultateve të pacientëve. Megjithatë, përvoja jonë si Roche në bashkëpunime me OMK-në dëshmon që për të siguruar integritetin dhe transparencën e bashkëpunimeve të tilla, janë të domosdoshme udhëzime të qarta, mbikëqyrje etike dhe përkushtim ndaj interesave më të mira të pacientëve. Duke punuar së bashku në një mënyrë të përgjegjshme dhe transparente, ne si dy nga aktorët më të rëndësishëm mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në avancimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor në Kosovë, por edhe mbrojtjen e interesit të pacientëve dhe integritetit të profesionistëve shëndetësorë.

Kalendari i aktiviteteve për vitin 2023

Institucioni/Shoqata organizuese e aktivitetit	Tema	Koha e mbajtjes së aktivitetit
Klinika e Kardiologjisë QKUK	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Klinika e ORL-së - QKUK	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Klinika e Dermatologjisë - QKUK	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Klinika Pulmologjike - QKUK	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Klinika e Pediatriisë - QKUK	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor-2023
Klinika e Hematologjisë - QKUK	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Klinika Infektive - QKUK	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Prishtinë	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Fushë Kosovë	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Drenas	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Junik	Ligjërata vjetore profesionale	Janar- Dhjetor 2023
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Malishevë	Ligjërata vjetore profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Vushtrri	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Gjakovë	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare - Podujevë	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Prizren	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare- Gjilan	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Qendra Kryesore Mjekësisë Familjare - Pejë	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare- Viti	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Shoqata e Neurologjisë e Kosovës	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Kolegji i Kirurgëve të Kosovës	Ligjërata profesionale	Shtator- Janar 2023-2024
Poliklinika diagnoza - Gjilan	Ligjërata profesionale	Janar- Dhjetor 2023
Action for Mothers and Children/Aksioni për Nëna dhe Fëmijë	Ligjërata profesionale	Janar-Dhjetor 2023
Oda e Mjekëve të Kosovës	Kongres multidisiplinar	27-28 Tetor 2023
	Dita Botërore e Kancerit	04 Shkurt
	Dita Botërore e Dëgjimit	03 Mars
	Dita Përkujtimore e Profesionistëve Shëndetësor	16 Shkurt
	Dita Botërore e Shëndetit	07 Prill
	Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut	14 Qershor
	Dita Botërore e Goditjeve Cerebrale	29 Tetor
	Dita Botërore e Shëndetit Mendor	10 Tetor
	Muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit	Tetor
	Dita Botërore e Diabetit	14 Nëntor



Shtator, 2023

omk-ks.org/revista-mjeku

